

# MITRUSH KUTELI

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-1  
K 98

BALTE  
NGA KJO  
TOKE

vjersha e poema



814-1  
K 98

5

MITRUSH KUTELI

# BALTË NGA KJO TOKË

Poema dhe vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NE VEND TË PARATHËNJES

«Baltë nga kjo tokë», është një grusht dhe e gur, një copë fushë e mal, një dorë bar e gjeth, një lehë pyll nga malet tanë e një lehë tërfil nga fushat tonë, një shoshë qiel e një bucnelë ujë, një gjeratore fllad nga liqeni e një dallgë stuhi nga koha ose, duke u shprehur me dy fjalë, është një copë Shqipëri. «Baltë nga kjo tokë» nuk flet se si është gatuar kjo tokë në epokat e ndryshme gjeologjike, por se si është mbrujtur me gjak e me zjarr në historinë e saj të pasur mijëvjeçare dhe se si elementi kryesor, që e ka bërë atë të qëndrojë solide e të mos shkoqet përpara vërvimeve të ndryshme historike, nuk është humusi, gëlqerja e hekuri, po është gjaku:

Pa malet dhe fushat ilire u lkuqën  
me curkë gjaku të pastër, të dlrët  
trimash, që emrin dhe kockat bashkuan —  
për jetë e mot me dheun bukëdhënës

(Rrjedhin lumenjtë)

*E*, duke qëmtuar në lashtësinë tonë, ndonse medisa «kufizime ideore», siç pohon me të drejtë N. Jorgaqi në studimin «Rrëfimet e Mitrush Kutelit» dhe ndonse në poezi ai nuk arrin të shprehë ato shqetësimë e tronditje të thella sociale, që shpreh me aq vërtetësi në tregimet e tij «Baltë nga kjo tokë» përshkohet, nga fillimi në fund, prej një fryme të ngrohtë popullore e prej një ndjenje të ciltër për natyrën e përnjerëzit e thjeshtë. Dhe është pikërisht ky intimitet e kjo ciltërsi me natyrën, me fshatin e popullin punëtor, që e bën Mitrush Kutelin poet e poezinë e tij të freskët e të larmishme. Dhe është pikërisht ky intimitet, i cili bëhet më i fuqishëm e më shumëngjyrshëm, duke e pirë frymëzimin në gurrën e kthjellët të folklorit, që e bën poetin të nxjerrë nga dora vepra të ndjera dhe me origjinalitet të veçantë si «Balada e pyllit të gështenjave» një poemë, që i ka të rralla shqet në poezinë tonë.

Duke ecur në vazhdën e poezisë tonë të Rilindjes e duke huazuar edhe ndonjë të metë, siç mund të jetë në farë idilizimi i jetës të fshatit, retorizmi e tek-tuk prolikositeti, Mitrush Kuteli merr lryesisht prej saj frymen e shëndetshme të atdherdashurisë dhe, i pushtuar nga një ndjenjë e tillë patriotike, ai mban qëndrim në momente kyçe të historisë sonë. Republikën monarkike të vitit 1926 e quan «Rrjepublikë», nuk pajtohet me intelektualët xhahilë të cilët alarmohen për «fatkeqësinë» që i kanoset vendit nga «super-

*prodhimi intelektual», qëndron pranë popullit në momente të vështira, duke e bërë kështu «Baltë nga kjo tokë» një ditar poetik ku pasqyrohet vetëjeta e tij.*

*Shfletoj vjershat e Mitrush Kutelit. Rilexoj poemën ilire «Rrjedhin lumenjtë» e më kujtohet takimi i fundit që pata me shkrimtarin në spital. E gjeta në tavolinë, duke shkruar. «Nxitohem të mbaroj romanin për Ilirinë», më tha dhe vërejta se ishte mjaft i preokupar. E, duke ndjerë se, me gjithë dëshirën e madhe për ta mbaruar romanin, ndofta nuk do të arrinte ta mbaronte, dy muaj para se sa të mbyllte sytë përjetë shkroi këtë poemë.*

Hej, histori! Ti histori e lashtë  
e botës ilire  
përse më bren e bluan kaq dhimbshëm  
në orët e vogla të natës së bardhë?

*Dhe i frysmezuar nga të tilla ndjenja të flakta Mitrush Kuteli shkroi tënë jetën, bile edhe gjashtë-shtatë ditë para se sa të vdiste.*

VEHBI SKENDERI

## BALADA E PYLLIT TË GËSHTENJAVE

### KËNGA E PARË

Bubullon e vrungullon  
pylli i gështenjave  
nga këngët e vajzave,  
këngët e pranverave:  
— Gështenjë, moj gështenjëzë,  
mirë se të gjemëzë,  
mirë sot e mirë mot  
e si sot një jetë plot!  
Kemi ardhur të t'këndojojmë  
këngëtë e lashtëza,  
për fije të artëza  
dhe boshte t'argjëndëza,  
për lulen e kaçesë,  
e të manushaquesë,  
së bardhës poleskësë;

për trimin e vashonë,  
që po dëshëronenë  
presin të martonenë...  
... Pa na dil e hyr në valle,  
moj labardhja linjëmadhe;  
bluaje, moj mesmënjjollë,  
bluaje belthin e hollë...  
As na hyrë e ti, e gjorë,  
moj e bardha si dëborë...  
Tunde, trim, o tunde,  
kindën e fuştanesë,  
mëngën e cepkenesë —  
për ballë sedefenë.  
Më të zëntë mall i saj  
ta kujtosh me kujë e vaj...  
Mall i saj që përvëlon  
e të shtrydh, të bën limon...  
Shkundi, plak-o, shkundi,  
kindatë e flokesë,  
mëngëtë e xhokesë... .

Zunë vashat të këndojnë,  
zunë kronjtë të dëgjojnë  
edhe valthet të jetojnë.  
Këng' e tyre mori malet,  
malet sipër edhe pyjet —  
gjer ku piqenë me yjet.

Vall' e tyre mori dhenë,  
dhenë poshtë e përpjetë —  
gjer ku puthenë me retë.

Aty poshtë ne burimi  
bukuroshen e zu trimi.  
... Krisi dasma e gëzimi.  
Rrofshin e u trashëgofshin  
e m'u shtofshin, m'u shumofshin!

#### KËNGA E DYTE

— Gështenjë, moj gështenjëzë,  
mirë se të gjemëzë,  
mirë sot e mirë mot  
**e si sot një jetë plot!**  
Kam një lajm të ëmbëlë,  
të ëmbël të bardhëzë:  
më lindi një djalëzë,  
siç lind ylli në mëngjes,  
siç çel luleja me ves!

Bubulloi e vrungulloi  
pylli i gështenjave:

Grykave dhe majave,  
çukave dhe pllajave,  
i ra dega degësë,  
i tha fleta fletësë,  
fletës së gështenjësë:

— Ç'bëni, moj shoqe, ku jini,  
a u ngrittë apo flini?  
Nuk dëgjoni lajminë,  
lajminë të bardhinë?  
Na lindi një djalëthë,  
i bukurë i miturë,  
porsi yll i ndriturë!  
T'i dhurojmë drurinë  
për të bërë djepinë!

— Do t'i fal — tha bisku trim —  
unë vetë trupin tim,  
që të tundë kurminë,  
kurminë të miturë,  
edhe të parriturë,  
të dëgjojë këngënë,  
zëthinë e nënësë,  
Kur i thonë foshnjësë:  
«Llaj e llaj e urullaj,  
«Vogëlosh, fli e mos qaj..

«Kur të zgjohesh do t’ të laj  
«me ujë të vakëzë,  
«me shkumbë të bardhëzë,  
«të të fshi me napëzë...  
«Fli gjumin e shqerrave,  
«edhe të mëshqerrave,  
«fli që të më rritheshë,  
«më t’ u rritshin ditëtë!  
«të më zbuluroheshë  
«e të trimëroheshë,  
«Të shumëshumoheshë. . .»

— Unë — foli trungu plak, —  
drurin tim tani i jap:  
të bëhem govatëzë, —  
nëna të ma lajë,  
moj po atë djalë,  
pa do bëhem qerthullë,  
qerthullë e rrrotullë, —  
të mësojë këmbëtë  
që të ecë vetëmë,  
e të bëhet trim me fletë,  
trim pa cen e pa të metë!

Do t’ i shpje, moj, do t’ i shpje,  
si dhuratë që këtej:

këngën e fëllëzësë  
shushurimnë e erësë,  
tingëllimnë e zilesë,  
bukurinë e lulesë,  
të kuqtit e thanësë  
edhe të lufatësë;  
të bardhët të hënësë,  
ëmbëlsit e tokësë...

Do t'i shpje dhe do t'i shpje  
si dhuratë që këtej:  
këngëtë e krojeve,  
ëmbëlsitë e hojeve,  
bukuritë e yjeve,  
qetësitë e pyjeve...

— Gështenjë, moj gështenjëzë,  
prapë të kam ardhurë,  
për gjësend të ëmbëlë,  
që të mëkoj foshnjënë,  
se është e miturë,  
edhe e parriturë;  
që të mëkoj birinë,  
birinë e gjiritë  
edhe të pëqiritë...  
Pa ta rrit, ta trimëroj,

nëpër botë ta dërgoj:  
nëpër punë të punojë,  
nëpër luftra të lëftojë  
e si trim të trimërojë,  
të na mpruajë vendinë,  
vendin ton' të shtrenjtinë!  
M'i ra dega degësë,  
gështenja gështenjësë:  
m'u shkundën sheputkatë,  
më pikuan boçkatë,  
boçkat e gështenjave...

Pa m'u bënë hoj' e mjaltë,  
Zoti djalin na e faltë!

— Ah, se moj gështenjë ti,  
nënë ti e babë ti,  
e mburojë në të zi...  
Janë derdhur mizëri,  
egërsira lukuni,  
që nga anë e anësë  
edhe që tej valësë,  
nga plac' e xhehnemitë,  
qentë e sadrazemitë,  
ujqtë e italianitë,  
bishat e gjermanitë;

armiq tē mallkuarë,  
me shpata nē duarë,  
mbi kuaj kaluarë,  
me hekur ngarkuarë,  
gjith thumba thumbuarë. . .  
Pa vrasin e presinë,  
gjë nē këmbë s'jesinë,  
as foshnjat e djepitë,  
as gurët e varritë. . .  
Qofshin majë huritë,  
n'hallkë tē litaritë!

M'u këndoftë nē shtëpi .  
qyqja edhe korb' i zi!  
Unë e mjera ku tē shkoj,  
foshnjën time ta shpëtoj?  
A s'm'u hap, gështenjëzë,  
nënëzë e babëzë,  
që tē fshihem pakëzë. .  
Edhe mbyllu përsëri  
mos na shohë qeni i zi!

Ushëtiu e bubulliu,  
pylli i gështenjave,  
shesheve dhe majave,  
rraheve dhe pllajave. . .

I ra dega degesë,  
i tha fleta fletësë,  
fletës së gështenjësë:  
— A s'm'u hapni, shoqëza,  
të na fshihet motrëza!

M'u hapën zgérbonjatë,  
m'u çelën gëmushatë,  
e m'u ngritën ushatë,  
të më fshihen nënënatë,  
nënënat edhe foshnjatë  
dhe shpëtuan jetënë  
brenda në gështenjatë.

### KËNGA E TRETË

— Gështenjë, o moj gështenjë,  
mirë se të gjemë!  
A s'më fal lëvozhgëzë  
nga filizi i njomëzë —  
të bëj glyrë, të glurojë,  
pylli gjithë të kumbojë,  
bota gjithë të dëgjojë...

Dhe më jep, gështenjë e gjorë,  
kambalecë për dëborë,  
edhe dru për shaqilorë,  
strumbullar për elelicë,  
edhe plashta për razhnicë...  
Të më lësh të ngreh në brinja:  
pesë kraza për mëllinja,  
edhe zjarr nëpër dëllinja;  
të mëunjësh bisqetë,  
të arrijnë kedhetë,  
të të hanë fletënë.

— Gështenjë, gështenjëzë,  
dua dru për lundrézë,  
për ballën e koretë,  
që të çajë ujratë,  
shkumbën e liqenitë,  
ku përpiqen dallgëtë;  
dallgëtë me maletë;  
ku vërtiten xhindretë,  
xhindret e pafundmetë,  
të rrëshqasë tejpértej  
përmby resë e mbi zej,  
nëpër shkumë të shkumbosur,  
nëpër erë të nakatosur  
nëpër xhindër të xhindosur...  
gjer ku hapet uji i zi,

dhe të kthehet përsëri,  
si shqiponjë, me lavdi!

Dhe sërish, gështenjë, dua:  
syllynjarë për një krua,  
dua e një lug të gjérë,  
të më mbledhë ujet tërë,  
që të lajnë nusëria,  
që të pinë bagëtia...  
e të dehenë fëmija.

Pa dëgjo, gështenjë, ti,  
dua trarë për shtëpi,  
dua an'je për çati,  
dua pendë për mulli  
edhe zjarr për mot të zi,

dua rrathë për kular,  
dua drrasa për grunar  
e purteka për ugar;  
papo dua përsëri:  
barrë me qymyr të zi,  
që të zbutet hekuri.  
të më bëhet plug e pluar  
dhenë tim për të punuar.

Dua armë tē farkoj,  
dua shpatë tē shpatoj,  
se do shkoj që tē lëftoj!

— Ah, se moj gështenjëzë...  
kam një lajm tē hidhur fort,  
lajm tē zi e lajm pér mort:  
më ka vdekur nënëza,  
nënëza e mjerëza,  
që më fali jetënë,  
e më tundi djepinë,  
që më mbajti e më mproi,  
e më mçoi e trimëroi...

A s'më jep, gështenjëzë,  
a s'më jep dru pér qivur,  
dru tē fortë, dru si gur,  
tē më mbledhë eshtrëzat,  
eshtrëzat e asaj nëne...  
Të m'i mbajë njëqind vjet,  
dheu i zi tē mos i tret' —  
... gjer t'i vete unë pranë.

Psherëtiu me zë njeriu,  
zë njeriu tē pikëlluar,

një gështenjë e vetëmuar,  
edhe djalit më t'm'i tha:  
— Eja, biro, me nxitim,  
eja çaje trungun tim...  
Të ma çash me tri sëpata,  
një të rëndë e dy lata —,  
dy latore me dy heje —  
të më hynë gjer në deje,  
gjer ne zemra q'u bë zhur.  
As do qaj, as do vajtoj,  
as me kujë do kujoj,  
do duroj, duroj, duroj,  
siç durova gjëmë plot,  
ças për ças e mot për mot. .  
siç durova sharrënë,  
siç durova zjarrinë,  
zjarrinë që më përpiu,  
edhe dhinë që më griu,  
më hëngri filizatë,  
pa më hypnë drizatë,  
gjer në zemër — shtizatë  
e ma thanë fletënë.  
Rreth e rrotull anembanë  
iknë shoqet e më lanë  
të mjeruar, vetëmë...  
Mbeta qyqe mbi përrua,  
po as qyqja s'ësht si mua;

qyqja ma ka pendënë,  
unë s'e kam fletënë. . .

Kam një zjarr në zemërë,  
s'kam kujt t'i rënkonemë:  
t'u rënkonem krojeve,  
krojetë shteruanë;  
t'u rënkonem kodrave,  
kodrat u shkretuanë;  
t'u rënkonem shpeshëve,  
shpeshët u larguanë,  
kodrat u shkretuanë;  
gérxhet mbetnë lakuriq,  
zogjtë mbetnë pa furiq.  
Pa më iknë ketërit  
edhe pisérëngatë.  
Do t'i qahem edhe truhem  
veç asaj së mjerësë,  
zemerbardhës nënësë.  
As më bëj dru për qivuar  
që ta mbaj në krahëruar,  
që ta mbaj e të më mbajë,  
që ta qaj e të më qajë  
e bashkë të tretemi  
hi në hi të mbetemi. . .

KËNGA E KATËRT

Kurrë «jo» gështenja s'tha,  
çdo që kish ajo e dha!  
I dha fletën bagëtisë,  
i dha pemën njerëzisë,  
u bë djep, u bë qivuar  
edhe hu për shaqiluar,  
u bë trarë për shtëpi  
e koritë për mulli,  
u bë lundrë që lundroi,  
u bë shpatë që shpatoi,  
u bë shtrofkë që na mproi,  
pa u bë qymyr i zi,  
dhe u tret e u bë hi,  
gjith e gjith për njerëzi...

Pa kur ardhi italianji,  
pendëkorbi si shejtani,  
ngriti sharrën e sharroi,  
ngriti top e copëtoi,  
ndezi zjarr e përvëloj:  
gjithë pyllin ma shkrettoi,  
gjithë vendin ma shëmtoi...

Ku më je, gështenjëzë,

nënëzë e babëzë?  
Ku më është boçkëza  
eëmbël si mjaltëza?

Ku më është shushurima,  
shushurima e fletësë,  
që më sillte gjumëthin,  
të lehtin, tëëmbëlthin?  
Ku më janë shpeshëtë,  
që kurdisnin këngëtë?  
Ku më janë, ku më janë...  
Gjithë shkuan, gjithë vanë,  
m'u shkretuan pllajatë,  
mbetnë zveshur majatë,  
m'u shëmtuan kulmetë,  
s'ka se kush ndal sulmetë,  
sulmet e lumenjve,  
gjëmat e përrrenjve,  
helmet e gjerprenjve;  
s'ka se kush ndal vrulletë,  
vrulletë e erësë,  
të dimër skëterrësë.  
Shteruan burimetë,  
dual hidhërimetë...

## KËNGA E PESTË

Që nga dita e çlirimt  
anembanë Shqipërisë  
kumboi zëri i partisë,  
kumboi zëri i kushtimit,  
i tha popullit, rinisë,  
i tha trimit pionierit:

— Pyjetë t'i ruani,  
koriet t'i mpruani,  
kodrat, rripat t'i bleroni,  
rrahet gjith t'i pyllëzoni.  
Pylli është pasuri  
dhe shëndet e bukuri!

Fjal' e saj — një kokër ar,  
ra si shiu në behar,  
që sjell jetë, begati  
dhe gëzim e lumtëri.

— Ç'janë, vallë, ata flamurë,  
që po skuqin pllajave?  
Kush këndon e sokëllin,  
grykave dhe majave?

— Ato jan shamit e kuqe,  
çet' e pionierëve,

që i shpjnenë gaz e jetë  
pyllit të gështenjave!

Anembanë po buçasin  
krismatë e kazmave —  
për të hapur nëpër rrahe  
gropat e fidaneve:  
të valojnë nëpër kodra,  
si flamur — blerimetë,  
dhe të na këndoijnë ëmbël  
zogjtë e burimetë...  
Edhe togjet me gështenja  
plot e plot oborreve...  
dimrit gjymet të valojnë  
vatrave dhe poreve;  
e të hajë foshnja e gjirit,  
plaku i motuarë,  
edhe etjenë ta shuaj  
me verë t'kulluarë.

— Gështenjë, moj gështenjëzë,  
mirë se të gjemëzë:  
mirë sot e mirë mot  
e si sot e vjete plot!  
Vjen që të sjellë jetë  
pionieri trim me fletë!  
Që të do edhe të mpron  
edhe vendin na bleron.

## BALADA E UDHËS NËPËR NATË

*Kushtuar kujtimit të mikut tim të  
kohës së vegjëlisë, plakut të mirë  
Sandri Kaçkës nga Pogra-  
deci.*

Ti mos më prit, o fshati im,  
në muaj maj, as në qershori,  
se vi i lidhur këmbë e dor'  
dhe kthehem kredhur n'hidhërim.

Jam peng ndër pranga q'udhëtoj,  
të mbroj kolonën në rrezik,  
ah, të mallkuarin armik —  
pa vi dhe shkoj, gjith vi dhe shkoj.

---

Më 1942-43, për të mbrojtur autokolonat ushtarake nga sulmet partizane, që i godisnin, digjnin dhe shkatërronin, autoritetet italiane shpikën një torturë të re djallëzore: merrnin peng prindërit e partizanëve dhe i hidhnik, të lidhur, në kamion të hapur, nën grykat e mitralozëve të rojeve. Këta

Unap' i gjelbërth që férmon,  
s'do të më njohë kurrsesi  
të veshur tërë tym të zi  
dhe të gozhduar në kamion;

as penā' e remës që buçet,  
as kodrat tonë plot blerim,  
as i pañjeturi burim,  
që gurgullor në gji të vet:

s'do të më njohë i largti vir,  
tek ngjizet dallga edhe vjen,  
me rrukullimë, në liqen —  
ndaj do më shohë në zinxhir.

Do ngazëllohet korbi plak  
në maj' të plepit iletergjënd,  
kur do nuhatë përnjëmënd  
vargonj të njomurë me gjak.

---

kamionë i vinin në krye, në mes dhe në lësht të autokolonave  
dhe i mbartnin poshtë e lart nëpër udhët e Shqipërisë: në  
diell, në shi, në dëborë. Në rast sulnesh partizane, fašistët  
vrisnin së pari pengjet. Një nga këta «pengje» ka qenë Sandri  
Kaçka, babai i dëshmorit Kristaq Kaçka të brigadës XV, që  
ra në ullishtet e Elbasanit.

Sandri Kaçka vdiq pothuaj i verbër, pas çlirimt, si paso-  
jë e vuajtjeve që kish hequr në «kamionët e pengjeve».

Do qeshë qeni tradhëtor,  
q'e bëri vendin hi e shkrumb,  
pa gazi i tij, i rëndë plumb,  
do të më therë në krahror.

Dhe për murishtat anekënd,  
të mbytura në drizëri,  
do të më dhembë përsëri  
mundim i madh i bijve tënd.

... Pra mos më prit, o fshati im,  
në muaj maj, as në qershori,  
se vi i lidhur këmbë e dor'  
dhe shkoj i zhytur n'hidhërim.

Po shorti im qe short i zi:  
në fund të majit, në kamion,  
të lidhur kuspull me vargonj  
më flakin rishtas n'errësi'.

Kamioni ynë ngjit e zbret,  
pas tij kolona varg e varg,  
dhe natë e zezë rrëth e qark  
dhe lart milici me helmet.

Por djathtas, majtas, lufta vlon  
dhe shkrepin flakë n'errësi':  
të falem ty, o djalëri,  
që e paepurë lëfton.

E vogël je, moj Shqipëri:  
një hon përposh, një shkëmb përkrah,  
po këtë vrull ty kush ta dha,  
të shembësh një perandori?

Dhe zemra ime ndizet gjak,  
se jam ndër pranga, pra nuk mund  
të ngjitem lart, atje, gjëkund  
dhe të derdh plumb, që të marr hak.

Fortesa, tela anemban,  
kolona bërë hi, pluhur —  
prandaj çdo dru, çdo krep e gur  
seç shembëllen me partizan.

Bërtet i vrazhdi zë roman,  
kërcet me hov kërbaçi i zi,  
ah, mbi kurriz, mbi pleqëri,  
dërmon i nëmuri karvan,

se jam i mjerë hapsanik,  
me krahë e këmbë në zinxhir,  
nga vatra shkulur me pahir  
dhe flakur udhëve vërtik.

Ne jemi vetë i trembëdhjet,  
që shkojmë e vijmë dit e nat,  
ah, në kolonën që na mbart  
posht e përpjet, posht e përpjet...

Dhe rruga jonë nuk ka cak,  
as vojtja jonë s'ka kufi:  
Vijm' varavinga në Shqipëri,  
q'armiku të mos bjer' në lak.

Dhe nëpër natën plot gjëmim,  
kur shpirtin jep i blerti maj,  
kalojmë gërxhe dhe pastaj  
të shkumbëzuarin Shkumbin.

Pa vjen një amëz lule e bar,  
q'e sjell e hollëza puhi  
dhe s'di se qysh, nuk di se si,  
më dehu mali shqipëtar.

Atje në mal im bir lëfton,  
me bomba dore dhe dyfek,  
i bie latinit që na djek,  
që njerëz vret dhe fshat shkreton.

Harroj varguan që dërmish,  
çdo gjë harroj edhe thërres:  
«Ah, bjeri qenit të pabes!»  
Zëmbytur djalin tim e grish.

... Një shkrepëtimë terrin çan  
dhe quell i zymtë derdh rrëke,  
siç ndodh në maj, kur breshër bje,  
mbi të nëmosurin karvan.

Sëllø, kërbaç, ti breshër, shi,  
t'i kem zili të errtit ferr,  
që unë e ndjell e nuk më merr  
përgjithëmon' në hon të tij.

Në kurm si çurkë shqota ryny  
dhe drithërima më rrënqeth,  
kur zhaurin i blerti gjeth  
e gjaknë e rrembave ma ndryn.

Kjo jetë e hidhur fort rjë ngop,  
ndaj ik karvani ndër rrebesh —  
atë mbi shkëmb, më tej në shesh,  
mbi krye: qytë, breshër, shkop.

Kamioni lbardh e udha lbardh,  
kur merr kolona tatëpjet  
dhe breshëria gjith godet  
dhe pengu i gjallë brenda mardh.

Pa kuspull mblidhem dhe duroj  
të fundit rrësk të t'ëmblit maj,  
në fyt e ndjej të helmtin vaj  
dhe sytë mbyll të mos shikoj.

... Ne jemi vet' i trembëdhjet  
të flakur brenda në kamion,  
me mitraloz na kärcënon  
xhelat' i vrazhdë me helmet.

I shkëmbtë je, o vend shqiptar,  
i bukur je, i ëmbël je...  
po qysh mëshirë vallë s'ke  
dhe pse s'më fal një cep për varr?

Të fle ashtu siç flenë ata,  
që ishin e nuk janë më  
e të mos ndjej të ashprin zë,  
as prangën që më bren në krah.

... Por ja, më tej, një yll u ndez,  
zbardh Kasht' e Kumtërit përbri,  
pushon e nëmura stuhi  
dhe vagëllon i riu mëngjez.

Majmalet zgjohen n'agullim,  
buçasin grykat me përrenj  
dhe Zot' i madh, që kthjell e vrënj,  
më fal përgjumjen — ngushullim.

Ndaj zbehen yjtë lart në qiell,  
nuk di se qysh, nuk di se si...  
Një afsh i ëmbël, ngrohtësi,  
të mardhtin kurm seç ma mbështiell.

Shkrep agu i ditës me uror  
dhe qiell e kulme kuqëlon,  
tuliten mjegullat në hon,  
pa gdhihet dita një qershori.

Ky trup i mardhur avullon,  
siç avullojnë malet lart;  
karvani i ngathët që na mbart  
nëpër këthesa rrötullon.

Plot gas e shpresë frymë marr,  
kur rrëth e rrötull nis kundroj  
dhe vojtja ze më duket hoj,  
ndaj shoh greminën bërë varr.

Ja, autoblinda nxirë zhur,  
përposh kamionë nëpër hon..  
«Hej, rrofsh, o djalë, që lëfton!»  
dhe zemrën time e bëj gur.

Kamioni ynë merr përpjet,  
pas tij kolona varg e varg  
dhe agullima rrëth e qark —  
mbi ne fashisti me helmet.

Po ja, befas në një pusi  
karvan i qenit u kllaposh,  
«Milic i zi, tani t'u sos!»  
bërtas sa mund, me brogori.

Gërvijnë boshtet rrëth e qark,  
autokolona ngrin në vend  
dhe çet' e malit përnjëmend  
e kap armikun si në çark.

Buçet i vrazhdi zë barez  
dhe komandanti urdhër jep,  
që të dëgjohet cep më cep:  
«Të vritet pengu albanez!»

Milici dridhet nën helmet  
dhe mitralozin ngre mbi ne,  
ndaj shtang kolona nënë fre,  
por trimi partizan thërrret:

«Hej, çetë, ndal e mos qëllo,  
armiku ynë vjen me rreng,  
se na ka marrë pleqtë peng,  
tërhiq lart edhe qëndro!»

Ngurrojnë djemtë lart në breg,  
ngurrojnë trimat në pusi,  
dhe zbret kolona si stuhi,  
se hapur gjen të pjerr'tin shteg.

... Ne jemi vet' i trembëdhjet,  
të lidhur brenda në kamion,

që sipër horësh rrötullon,  
për tatëpjet, për tatëpjet.

Pse na kursyet, djem, përse,  
e nuk lëshuat zjarr e plumb  
kolonën që ta bënit shkrumb  
bashkë me ne, bashkë me ne...

Pa plag' e mpiksur fort më dhemb  
dhe hallk' e ndryshkur gjith më breh,  
ah, mish e kockë, porsi teh,  
dhe nuk më shemb, jo: nuk më shemb.

Më këmbë ngrihem e thërras:  
«Qëlloni, djema, pa kursim,  
se jetën japim për çlirim  
dhe vdekjen presim ne plot gas!»

Edhe kur ne të trembëdhjet  
na çon kolona me vërtik,  
me të mallkuarin armik —  
gjith çeta lart na përshëndet.

Dhe përmbi krye ç'i valon  
flamuri ynë i kuq si gjak,

që rrez' e diellit e përflak,  
ndaj zemra ime nis gufon.

Të shoh, flamur i kuq i zi,  
se shpresën gjallë ti ma mban  
dhe pres të ngrihesh anemban  
mbi mal e fushë, në Shqipëri.

Zien val' e shkumbtë në lijen,  
vjen qark zgalemi fluturak,  
nxiton kolona varg e varg  
dhe fshati, tutje, zbardhëllen.

## **LETRA E FUNDIT E NJË DJALOSHI PARTIZAN**

### I

— Do shkoj, nëno, tha, do shkoj:  
kaqe varre,  
kaqe zjarre,  
kaqe shokë në litare...  
Jo, nuk duroj!

Rri të ha e nuk ha dot,  
bje të fle e nuk fle dot,  
se vendi gjithë u mbyt me lot,  
në zjarr e lot,  
në gjak e lot.  
Nëno!

Më ndizet zemra kur dëgjoj,  
më erren sytë kur shikoj  
kaq lule zie nëpër mure  
dhe varret që përpijn' qivure.

Papritmas<sup>1)</sup> një,  
papritmas dy,  
papritmas ran' njëqind e dy.  
Kush ra në mal dëshmor,  
kush ra në burg theror...

Nëno!  
Lëftojnë shokët lart në mal,  
do dal!  
«Se ja të bëhet Shqipëri  
A ja të mbetet gur e hi!»

Ah, biro, jo,  
mos shko!  
Ty sy të kam edhe kandil:  
mos dil! —  
Dhe nëna qan,  
po djali i saj del partizan  
dhe lot i nënës nuk e mban,  
siç nuk e mban  
as mot i keq, që fryn e bie,

---

1) Me këtë fjalë fillonin më të shumtata e lajmërimeve të vdekjeve në kohën e okupacionit. «Papritmas» do të thosh «vrasje»: në rrugë, në shtëpi, në burg, në kamp... Tërë muret e Tiranës nxinin nga qindra dhe mijëra «lule të vdekjes», siç u thoshin kartave të përzishme. Shpesh, për të kallur frikën, okupatorët dhe shërbëtorët e tyre i hidhnin të vrarët rrugëve dhe i linin aty ditë të tëra. Por të gjitha këto, në vend që ta theynin, e forconin më fort qëndresën dhe luftën e popullit.

as qelli i mbarsur me rrufe,  
asgjë mbi dhe!

Se zemr' e tij ndër flakë u ndes.

Tha: «Shkoj të rroj a shkoj të vdes.»

Dhe roj' e çetës i thërret —  
me zë gjëmimi i thërret:

— Hej!

Kush shkel këndeja?

Ndal!

Ndal aty se hapa zjarr!

— Jam un, välla,

un yt välla...

vij që përtej,

ku vendi gjithë digjet zjarr,

ku varen shokë në litar

ku lorrat në kolltuqe rrinë

dhe hanë, pinë,

në treg e shesin Shqipërinë,

me këmbë shkelin vegjelinë.

— Eja, shok,

me ne tok:

«Për liri e Shqipëri»,

Shtëpia jonë do të jetë dushku

dhe larushku.

Do të lëftojmë mal më mal

dhe hovin ton' s'ka kush e ndal,

as rob,

as zot.

Dhe fjala jon s'do jetë fjalë,  
po zjarr e valë.

Dhe mblidhen shokët partizanë  
nga çdo anë —  
që nga Korça në Tiranë:  
«Me një torbë me fyshek'  
e një dyfek. . .»

Dhe sulm i tyre s'është sulm,  
po afsh rrufeje,  
që zbret prej reje.

Pa merr armiku zjarr pér zjarr  
dhe vetë bje tek hapi varr.  
— Ti paske tanks që flakë vjell  
dhe top të madh që vdekje sjell.  
T'i kam parë, t'i kam parë,  
djegur në Guadalaharë.

Dhe tanksi ndizet flakërimë  
me një shishe me benzinë,  
pa topat ndryshken buzë udhe  
ndër kërminj e ndër kërpudhe.  
Nga rrënja tundet skullavëria  
dhe milicia  
e njatij qenit «shkëlqesi»,  
që mbledh nga gjaku pasuri  
dhe e hedh në Itali:  
pér më von —  
në siguri;  
pa lë mal edhe lë fushë

për t'u mbyllur në kaushë.  
Dhe m'i shkon nami anemban  
atij djaloshit partizan...

## II

Por ja, sa bje Perandoria,  
vjen e na derdhet Hitleria,  
që ia vazhdon me zjarr e varr  
dhe ngre trikëmbshe në pazar.  
Pa vjen dhe dimri me dëbor,  
dhe shkurt i ngritë me terror  
dhe mercenari horr —

me pushtonjësin ortak  
për plaçk e gjak:  
e ndjek  
me mitraloz e me dyfek  
dhe i ngre prita nëpër shtek.

## III

Që nga malet **me dëborë**  
zbret brigada partizane:

vrulltas vjen e vrulltas shkon  
dhe lumenj në va kalon  
dhe këndon,  
dhe këndon një këngë lufte  
për liri e drejtësi,  
«Vdekje fashizmit» — një zë buçet,  
«Liri popullit» dikush ja pret...

«Si jeni, shokë?»

«Mirë, shoqe!»

Të gjakosur: «Mirë, shoqe»,  
të rreckosur: «Mirë, shoqe»  
edhe «Mirë» në uri...

O moj shoqja partizane:  
hodhe tej ato fustane,  
flake tej ato stoli,  
për të veshur veshje burri,  
për të bërë luftë burri,  
strehë qelli, shtresë guri,  
si iliret e qëmote  
edhe si motrat suljote. —

Fjala jote,  
fjala jote, flija jote  
vlug na jep edhe guxim,  
~~vdekjen~~ na e bën gëzim...

## IV

Ardhën shokët dhe i thanë:  
«Lajm të zi, o shok» ç'i thanë,  
«lajm të zi të sjellim sot,  
plumbi ta rrëmbeu vëllanë,  
flaka ta sheshoi shtëpinë...»  
S'bëri zë e s'qau për mort.  
«Un' shtëpi kam Shqipérinë,  
shokun tim e kam vëlla».«  
Tha kështu, u ngrit më këmbë  
dhe fshiu lotin me pëllëmbë:  
«Dua urdhër që të shkoj  
edhe gjakun t'ja shpagoj. »

## V

Por ja, na vjen një lajm i ri,  
që sjell jetë, gjalléri:  
Shokë,  
shokë!  
Sihariq se erdh pranvera!  
Ngjitet avulli përpjetë,  
plisit nis i ndihet era,

dhe në pllaja,  
gjer në majë,  
fletë

nisi të lëshoje pylli,  
rrrezeartë po ndrin ylli.

Ah, tanë:  
«Ja se vdekje, ja liri!»  
dhe me ngulm  
pritet urdhëri për sulm.

Hej,  
ti kukudh reaksionar  
dhe ti i verbti mercenar,  
përse më pret  
me plumb e zjarr?

Po arësyë Balli s'jep,  
si pemë s'jep  
një plep.

Dhe partizani e sulmon,  
me bomba dore e sulmon:  
«Ah, klysh i lekëve, ti klysh!  
Shokë, yrysh!»

Dhe mercenari mbetet horr,  
ta hanë sorrat mbetet horr.

Po partizani udhën hap,  
e ndjek nazistin çap për çap:  
«Pa dil, katil, pa dil këte  
të marrësh dhe,  
të kalbesh brenda përgjithmonë!»

Por ai qen katil nuk del,  
rrethuar rri me grep' e tel,  
dhe luftë bën për cilimi  
dhe vret grani  
dhe hedh në pranga pleqëri,  
dhe djek plëngje e shtëpi:  
... rrethuar rri me grep' e tel.

Por ja që tej,  
ku malet ngjiten lart në qiej,  
dëgjohet një gjëmim i ri  
dhe mizëri  
po vjen armiku me kolonë,  
dhe shkel dheun, valthin tonë,  
tankse sjell edhe çelik...

«Qëndro, armik!»

Dhe sa të thuash një, dy, tri,  
kreu i kolonës bëhet tym  
dhe bishti tym  
dhe gjith kolona shkrumb e hi,  
«Hej, o Hitler, ti nuk e di:  
kësaj i thonë Shqipëri!»

## VII

Mirditë, ti:  
male mbi male,

mure mbi mure —  
jetë babëzie,  
pranga skillavërie,  
shtuar e shumuar,  
rritur dhe rënduar  
me ferman Turqie,  
pare Austrie,  
dhe bekime Italie.  
Pa dergjet turma proletare,  
brenda natës mesjetare,  
nënë thundrat bajraktare,  
tyxhare  
për gjak.

.....

Thonë s'bje,  
sindëkur se s'rë as dje,  
se e mban  
një i fortë kapedan:  
mik për kokë me sultân,  
edhe mik me Austri,  
gjithmon mik me Itali,  
me atë që jep flori.  
— Kapedan?  
Prit të shohësh partizan,  
partizan me yll të kuq,  
flamurburbuq,  
që e mban hedhur asaj qafe;  
partizan që s'di e s'njeh

kapedanë përmbi dhe.  
Dhe malet ulen,  
kullat shemben  
dhe flak' e zjarrit vlon si det...  
se Mirdita u ngrit vetës,  
theu prangat e mesjetës.  
Ra,  
ra,  
ra  
përgjithmonë,  
përgjithëjetën  
skllavëria bajraktare  
që e fshiu me fshesë zjarri,  
katundari, proletari.

## VJI

Pa vjen fjala se në Prezë  
qenka mbledhur, qenka derdhur  
fundërrina faqezezë,  
që të presë mcnarkinë —  
të zbarkojë me Anglinë.  
— Prezë,  
prit!

Po nuk pret as agë as be,  
se kishin bërë shokët be —  
t'u bëjn' lëkurën dajire...  
Ikin burrat edhe lënë  
**mitralozët**, **xhephazënë,**  
**gjithë brezë;**  
**neanin ya e ngjitin kodër —**  
**ku më je, moj loka Shkodër?**

## VIII

Dhe sulm pas suimi, rrëzë Tirane  
zbritën çetat partizane.  
Ah, Tiranë,  
burg e varr për djemtë tanë...  
Se ti.  
dhe ti.  
dhe ti  
hajdut këmishëzi,  
shpirt-tyxhar e bejtexhi  
e shite vendin tënd ,  
për pasuri  
dhe bashkove Shqipërinë  
me Italinë,  
dhe si shpérblim, si tradhëtor,  
je «kavalier», komendantor».

Ti ngrite pallate mbi brigje,  
çifligje rrëmbeve!

me ligje!

Dhe grive, shqeve...

Ah, ligji yt —  
ligji i ujkut

qe ze per fyt e myt

Unë ta njoha ligjin tënd  
në fshat, qytet dhe anekënd.

Prite tanë  
dhe ligjin tim:

shkruar në burgje brenda

me gjak të kuq,  
dhe shkruar, bluar, përsëri  
në luftra, vojtje dhe uri,  
në dëborë dhe në shi,

në nete shkurti gjakatar,  
hijesh trikëmbshi me litar,  
nëpër rrebeshe e valoma,  
kur gdhihej dita me kufoma  
hedhur rrugës, në trotuar,  
flakur qenve në pazar...

edhe kur, nëpër shtëpi,  
nënrat qanin logori,  
se erdhi dita kur Pylli i Brinjës  
t'i turret Malit të Dusinjës —  
si në vegimin makbetian

Dhe Shën Prokopi ndrit, shëndrit

dhe hedh predha si **xhirit**.  
Por mbylllet rrëthi qark e qark,  
armiku mbet në thark.  
Do të ikë e s'ik dot  
dhe përpëlitet kot më kot.  
Mor Hitler, o mor i gjorë,  
predhën po ta pres me dorë,  
siç ta pritën, o i ngrat,  
atje tej në Stalingrad,  
ku të bënë hi e shkrumb.

## IX

Pa një mëngjez,  
kur bij' ngadal një pikë ves' —  
situr hollë nëpër sitë,  
nëpër mjegull, nëpër dritë,  
ay djaloshi partizan  
rri në gur, i shkruan kartë  
nënës tija zemërzarrtë:  
«Ti, nëno moj,  
tanithi sosa rrëzë Tirane,  
dhe së këtejmi të dërgoj  
shumë të fala partizane.  
Dhe në pyeç: si jam, si shkoj —  
shëndosh e mirë, dhe lëftoj

me shokë shumë: për Shqipëri».

Dhe ditë shkojnë e nete vinë  
dhe derdhet gjak për Shqipërinë,  
dhe bëhen sulme partizane  
brenda Tirane..

Ndarë më dysh, me tela, gropë  
dhe barikada,

ndaj ndizen zjarre flakadan.

Ay djaloshi partizan  
përpara prin edhe sulmon,  
përmes qytetit që gjëmon,  
dhe ja, befas, i ra në gji  
një plumb i valë kobëzi..

— Bini, shokë, se na vranë! —

Dhe u ranë  
ata trimat partizanë,  
zjarr për zjarr e varr për varr.  
— Të dhemb, vëlla?  
— Jo. Asgjë nuk ka...

Po gjaku derdhet si rrëke  
përdhe...

— Un, shokë, vdes:  
kujdes ma kini Shqipërinë  
dhe vegjelinë...

Dhe midis britmash vetëtime,  
si ndër vegime,  
vështron tej, — ndaj jepte shpirt, —  
ah, Shqipërinë e çliruar,

me gjak çliruar,  
mbi eshtra trimash të ndërtuar:  
    pa robëri,  
    pa skllavëri.

Dhe dor' e nënës shqipëtare,  
sa gjithë Shqipëria rritur,  
sa qiejt tanë, sa malet vetë  
e ledhatonte lehtë — lehtë...  
Pa vdekj' e fija s'ishtë vdekje,  
    po ëmbëlsi,  
    që s'ka kufi.

---

Priskë, tetor-nëndor 1944  
— lexuar në një mbrëmje letrare.

## KARTË NGA SHËNDAUMI

— E njoma pendënë në vrer —  
të nis t'ju shkruaj këtë kartë,  
ah, këtë kartë!

Sa tmerr, o zot, sa tmerr,  
ta njomësh pendënë në vrer!  
Kaq tmerr të zi e lemeri  
që panë sytë e mi —  
s'ka parë asnjeri.

... Shtëpinë e pashë kur m'u doq,  
e pashë foshnjën kur m'u poq —  
edhe tim shoq,  
po, dhe tim shoq!

Dhe jam q'ahere siç me sheh,  
ah, siç më sheh e nuk më njeh:

një fletë e thatë nëpër erë,  
kur në parajs, kur në skëterrë.

Edhe mendimi im...  
Ç'mendim!...

Un' natë për natë bredh ndër qiej,  
po, bredh ndër qiej  
e kur më shkrep shkoj tejpërtej,  
mbi male shkrumb, mbi kulme hej,  
po, tejpërtej.

Rrëshqas a strukem mbi selvi,  
si për çudi:  
se vetë zonja Shërmëri,  
se vetë zoti Shëndëlli  
më mbajnë sipër mbi selvi;

dhe shkoj me qerre që gjëmon  
dhe bubullon e vrungullon  
dhe zjarr lëshon —  
se tetë kuaj qerrja ka  
dhe tetë krahë kali ka —  
të kora e lashtë **atje** la.

**Dhe mjekra e zotit Shëndëlli,**  
**kjo mjekra e tija ngjyrë hi,**  
**zbret poshtë mbi selvi.**

Shtëpinë e pashë kur m'u doq,  
e pashë foshnjën kur m'u poq —  
etëhe tim shoq,  
po, dhe tim shoq!

4 Sa tmerr i madh, sa tmerr  
ta njomësh pendënë në vrer!  
Kaq tmerr të zi e lemeri,  
sa panë sytë e mi —  
s'ka parë asnjeri.

Për drekë shkoj ne zoti vet,  
ne zoti i madh e i vërtet',  
që rri në ret'  
me këmbët varurë në det.

Më thotë i shenjti: «Ulu, ha.»  
Dhe unë q'sh: «Hahaha!»  
dhe unë qaj: «Hahaha!»  
— Jo, misl prej foshnje nuk do ha.  
Dhe ik pas'aj e fluturoj,  
në qiej të verdhë si limoj,  
e shkoj e shkoj.

Tak-tak troket, tak-tak:  
«As hape derën pak,  
as hape shpirtin pak.»  
«Kush éshtë në çardhak?»  
S'përgjigjet asnjeri  
nga terri i zi.

I them: — «Hej, folë! Kush je ti  
në terr të zi?»

«Jam zonja Shërmëri.»

... I bje më gju, bëj metani,  
një herë, dy, dyzet e tri  
edhe lotoj si foshnjëri:  
«E'rgjëndë je, moj Shërmëri,  
e vojtur je, moj perëndi,  
se ti ke qarë, se ti di,  
sa éshtë e dhemshur një fëmi,  
sa éshtë e ëmbël një fëmi.  
Ah, kisha zonjë, një fëmi,  
dhe desha fort ta mbaj në gji,  
ta mbaj, ta rrit për Shqipëri,  
për Shqipëri!»

... Shtëpinë e pashë kur m'u doq,  
e pashë foshnjën kur m'u poq — po  
edhe tim shoq,  
po, dhe tim shoq!

Sa tmerr i madh sa tmerr.  
që panë sytë e mi,  
s'ka parë asnjeri.  
Pa nis qan zonja Shërmëri,  
aty, në sytë e mi:  
i rrjedhin lotët në shami.

---

Dhe nis e unë edhe qaj, po  
vajtoj, vajtoj me vaj.

O sa çudi,  
o sa çudi,  
të qajë zonja Shërmëri, po  
si qan një çilimi!

---

Më erren sytë kur ze qaj,  
më mbytet shpirti kur ze qaj,  
nga kaqë vaj:  
nga vaji im, nga vaji i saj.

Pa muret nis që t'i zgérmas,  
Ah, thonj-përgjakurë i zgérmas,  
edhe bërtas,  
porsi e çmendurë bërtas,  
ah, leshlëshuarë bërtas:  
«Gënjeshtër je, moj perëndi,  
gënjeshtër, zonjë Shërmëri,  
se po të ishit, s'ka se si  
të derdhej gjak në njerëzi,  
të vishejjeta në të zi:  
Jo, ju nuk jini asgjékund  
në botën që s'ka fund.»

... Tak-tak troket, tak-tak:  
«As hape derën pak,  
dhe zemrën hape pak.»

Dhe përsëri  
hyn brenda zonja Shërmëri.

Kjo zonjë e rëndë Shërmëri,  
kjo nënë e vuar Shërmëri,  
veshur me rgjend e me flori, —  
në dorë një qiri.

Dhe mbushet oda dritëplot,  
pa mbushet shpirti këngëplot,

dhe syri im s'ka pikë lot,  
o zot i madh, o zot!

E më ka zonja rrrotull saj  
një tufë ëngjëjsh të pafaj,  
dhe s'ndje më vaj...  
Pa midis ëngjëjve e shoh  
ah, foshnjën time dhe e njoh!

I bje më gju, bëj metani,  
një herë, dy, dyzet e tri:  
«E madhe je, moj Shërmëri,  
ti dorëlarë me flori,  
ti më ke ëngjëj mizëri,  
ah, falmë ti një mituri,  
ta marr ta mbaj në gjë,  
ta mbaj, ta rrit për Shqipëri..»

Dhe duart zgjata që ta marr..  
Këndon këndezi një, dy, tri  
e tretet zonja Shërmëri,  
si engjervi.  
Qiriri shuhet pas qiri  
e mbetem rishtas në të zi,  
në terr të zi,  
në lemeri.

O sa çudi,  
o sa çudi!  
Jam unë vetë Shërmëri —  
e s'di njeri,  
nuk di njeri!

Po mos i thoni asnjeriu,  
se del ariu  
nga kora e zotit Shëndaum:  
troket në shkallë bum-bum-bum,  
buçet në derë dum-dum-dum,  
e s'ka askush që të shpëton,  
kur bubullon e vrungullon  
e topi i shkretë kur gjëmon,  
kur mitralozi të gozhdon,  
kur qen milici të gérmon  
e yt vëlla të tradhëton —  
Paterimon... Paterimon...

Më thirri i shenjti e më tha —  
i rrepti Shërmëhill:  
«Pse s'vjen, moj bijë, atje la,  
ku brenga s'ka, ku dhembje s'ka?» —  
me gojë vetë seç më tha.

S'i thashë: po,  
s'i thashë: jo,  
se un' pres foshnjën që t̄ shoh

e ndér njëmijë do ta njoh.  
Po, do ta shoh!  
E miturë është e sisë do,  
e vogël është e këngë do —

«Më lerë e shko!»  
Dhe iku zoti Shërmëhill,  
u fut në kora, në kandil.

Pa ngrihem natën e këndoja,  
ah, foshnjës sime i këndoja:  
«Tumna, tumna, tumnana!  
Këtë foshnjë kush e ka?  
Kush e ka e kush e do?  
Kush s'e ka e kush s'e do?  
Obobo, obobo!»

Ah, foshnja ime u bë hi,  
e unë klith nëpër çmendi.

Po sonte prapë do fluturoj  
në qiej të verdhë si limoj,  
në qiej të athët si limoj  
dhe foshnjën time do kërkoj,  
do fluturoj!

Mos qeshni, zonja e zotëri,  
se flas kështu si çilimi,  
se qaj kështu si mituri,  
e veshur tërë në të zi,  
në një qelizë në çmendi,  
këtu brenda në çmendi.

... Shtëpinë e pashë kur m'u doq,  
e pashë foshnjën kur m'u poq.  
Sa u përpoq!  
Sa u përpoq!  
Edhe tim shoq..  
Dhe qindra njerëz si tim shoq  
e djem të varur në litar,  
kuçoma hedhur në pazar,  
e gjak të kuq në gur të zi,  
fashistë qena mizëri.

Më vjen nga thellë të bërtas,  
në mes të natës të këlthas  
e majë botës të buças,  
që të dëgjojë fund e krej,  
kush gjak njeriu ka në dej:

Perandori!  
Perandori!

Perandori, xhehnem i zi,  
ti, nëmëmadhe Itali,

ti që më solle robëri.  
ti që më veshe në të zi,  
ti që më mbylle në çmendi,  
u bëfsh hi!  
E mos të mbettë gur mbi gur,  
po vetëm pluhr,  
ah, vetëm pluhr!

Tak-tak trokas, tak-tak:  
as hapni derën pak,  
dhe shpirtin hape pak...

*Shtator, 1943.*

## **TEUTA ILIRE**

Llapi romaku zeshkan  
përpara Teutës ilire,  
bardhoshes Teutë ilire,  
me zë të vrazhdë, noprani,  
dhe ngriti pëllëmbën krenar,  
dhe kokën e ngriti me zulm,  
i dehur nga vrulli gojtar,  
sikur të kish qenë në kulm  
të podiumit patrician,  
brenda në *Forum Romanum*:

«Ky det është yni, i Romës,  
që nga një buzë tek tjetra,  
dhe nga një valë tek tjetra.  
Pra lundra ilire s'do lerë Roma  
të shqasin mbi ujrat e detit.  
Dhe urdhëroj, në emër të Romës,

të jepni galerat ilire,  
të gjitha anijet ardiane  
dhe gjithë lundrat liburne  
dhe tërë detarët e tyre  
të lidhur me pranga në duar, —  
t'i varim lart, në sterenë, —  
trofera në emër të Romës!  
Dhe dua rishtas, me ngulm,  
ulkonjës sonë romake  
t'i fali të gjithë sa jeni  
ju, fiset e shumta ilire.  
Se deti është yni, ta dini:  
që nga një valë tek tjetra,  
që nga një buzë tek tjetra!»

Dhe zëri ndaj ngrihej i dehur,  
dhe krahu ndaj ngrihej i hedhur  
dhe fryhej fikthi zeshkan,  
si brenda në *Forum Romanum*.  
Shëndriti një shpatë ilire  
dhe vringëlliu...

Përnjëmend  
nga trungu i shtatit të shkurtër  
kërceu koka zeshkane  
dhe shkoi rrukullimthi  
në tokën e lashtë ilire,  
në tokën e shenjtë ilire.  
... Dhe s'llapi më goja oprane.

Se vetë Teuta ilire,  
e rrepta Teutë ilire,  
bardhoshja Teutë ilire  
ja preu kokën romakut.

## SPARTAKU

Me Romën e vrazhdë luftoi Spartaku.  
Rodopi i shkëmbtë nga rrëza u tund...  
Plakosën legionet dhe Thraka u mund,  
në bandra të rënda skllavrie ra thraku.

Nën thundrën tirane — mundime pa fund,  
se shkelte dhe shtypte pa zemër romaku...  
Por skllavi i paepur, qytetit te praku  
pishtarin ia shpuri dhe zgjedha u shkund.

Luftoi kryengritësi dhe vjete me radhë,  
i kuqi skllav e mundi xhelatin e bardhë  
dhe dërmën pareshtur ushtrive u dha.

Po Roma kuçedër kish shtatëqind krerë,  
përmbysej përtokë, por ngrihej pérherë,  
gjersa vigani i Thrakës në luftë u vra.

## VARR MILICI

Kalbet kryqi përmbi dhe,  
kalbet kërma poshtë tij...  
E pyeta: — Cili je?  
— Jam, më tha, këmishëzi.

— Qofsh gjithmonë, aty, siç je,  
kallur brenda pa savan,  
po më thuaj: qysh e pse?  
Tha: — Më vau një partizan.

Pata bredhur mal e det,  
nga Madridi në Harar,  
pastaj duçja me gjith' mbret  
m'hodhën në dheun shqiptar.

Dhe tanj seç mbeç' këtu  
me të ndryshkuran helmet.

Thyer kokë, dorë e gju —  
toka juaj po më tret.

— Nuk më thua, ore ti,  
ç'bëre vall' në dhe shqiptar,  
Spanjë edhe Abisini?  
Tha milici: — Vura zjarr;

hi e bëra çdo tukul,  
çdo kasolle dhe shtëpi,  
edhe hovi nuk m'u ul,  
as kur dogja pleqëri.

Dhe më hodhën më kët an'  
për të djegur një katund,  
po më pa një partizan  
e më shtriu përdhe me plumb.

— Mbiftë ferrë, mbiftë gjemb  
mbi varr tënd, t'i kesh mbi krah  
e mbi kryqin që t'u shemb  
korbi thirrtë kra-kra-kra.

... Rritet gjembi përmbi dhe,  
kalbet qeni, bëhet pleh:  
Emrin ia ka fshirë era,  
shpirtin ja përlau skëterra.

1943.

## PRISHTINA

Prishtinë, ti  
burg vigan,  
varr vigan!  
Aty tek ty,  
në dheun tonë të amëshuar,  
— lidhur në pranga,  
robëri pas robërie,  
u dergjën,  
hoqën e vojtën  
dhe ranë fli  
për yllin e kuq të Shqipërisë së re,  
për drejtësi  
dhe për liri,  
bijtë e vendit,  
më të zgjedhurit,  
më të mirët,  
martirët!

1944

## NATË VJESHTE

*Një nga netët e para pas çlirimimit  
të Tiranës, në një shtëpi përdhese,  
një nënë qante me zë të mbytur të dy  
djemtë e vrarë në kampin e Prishti-  
nës. Njërit i thoshin Kristaq, tjetrit  
Kostaq.*

Vjeshtë e gjatë,  
natë e gjatë...  
Bie shi  
rrëmbyer,  
papushuar  
dhe bluan tokën e gurët bashkë.

Dhe brenda në natë,  
në shi, errësi,  
nëpër gërmadhat që lanë prapa  
mortajat dhe zjarret e fundit

hitleriane,  
një nënë  
e padukëshme,  
vatërshuar,  
vajton  
me logori  
të dy djemtë e vrarë larg,  
në kampe,  
për Shqipëri.

Tani pushoi,  
ndofta u lodh  
dhe rri e mekur  
(a mbase qan me zë të ulët  
po muret,  
shiu,  
dhe era  
ja mbytin zërin?)

Dhe shiu i vjeshtës,  
që bluan tokën e gurët bashkë,  
vazhdon  
papushuar,  
rrëmbyer.

Tiranë, dhjetor 1944

## BALTËS SHQIPTARE

Të dua, baltë shqiptare!  
të dua  
egërsisht,  
dëshpërimisht —  
si ujku pyllin,  
si vala valën,  
si balta baltën!

Se gjer mbi gju  
jam brenda teje;  
se lerë kam këtu  
si ati,  
gjyshi,  
stërgjyshi.

Të dua, baltë shqiptare,  
se gjer mbi bel  
dhe përmbi bel,

jam brenda teje  
e s'dal dot —  
se s'dua!

Se ti më lidh  
e më mban  
me mjaltin tënd  
dhe me pelinin tënd!

Se vdekur ka,  
këtu, tek ty  
dhe nëna  
dhe ati,  
dhe gjysh-stërgjyshi!  
Të dua baltë shqiptare,  
magjistare,  
e ëmbël dhe qetësuese —  
si vetë vdekja!

Se thellë jam, këtu,  
brenda teje:  
gjer mbi gju,  
gjer mbi bel  
e gjer mbi krye;  
dhe dua fort të dehem,  
me afshin tënd  
të prehem

(ah, që tani dhe përgjithmonë!)  
brenda teje;  
të të pushtoj,  
të më pushtosh;  
të të shtrëngoj,  
të më shtrëngosh  
e të më tretësh  
si gjysh-stërgjyshët  
e si po tret  
ah, flokëbardhin  
e shtatzhuriturin  
babanë!

Të dua baltë shqiptare,  
magjistare,  
ti, mjaltë e ëmbël,  
ti helm e hidhur!  
Të dua:  
egërsisht,  
dëshpërimisht :

si ujku pyllin,  
si vala valën,  
si balta baltën!

Shtator, 1943.

## GJUHËS SHQIPE

### I

Të falem ty, o gjuhë-shkëmb,  
me rrënjet thellë në shkëmbënj,  
që çave qielin kur t'u vrënj  
dhe shembe bisha e shtërpënj,  
pa mbete prapë

shkrep e shtëng;

të falem, gjuhë-shkrepëtim,  
që shkrep në qiej e vrungullon,  
me bujë pyjesh bubullon,  
me gjëmë detesh uturon,  
dhe je, siç ishe,

vetëtim;

të falem ty, o gjuhë-hoj,  
ty, zëth i nënës — qetësi,  
ty, këngë e foshnjës — kaltërsi,  
ty, afshi i zemrës — dashuri —  
gjithmon e ëmbël —  
mjaltë zgjoi.

## II

Të falem ty, o gjuhë e fisit tim,  
siç nuk i falem asnje perëndi —  
se tempull i përjetshëm më je ti,  
dhe ti mburoje nëpër mot të zi:  
ti, dritë e krirtë nëpër errësi,  
ti, perëndi, që nuk ke perëndim.

## III

Të falem ty, o fis i vendit tim:  
Ilir i lashtë, arbër i ri —  
dhe sot shqiptar në shumë Shqipëri...  
ty, i paepur popull luftëtar,  
qëndresë e fortë në luftë e zjarr;

ty, o gjahtar i moçëm me hobe,  
dhe ty, bari, me hark e me kope,  
ty, bujk, me shpatë e me qe,  
ty, nënë e dhemshur e grua-gur,  
ju, që me shtatet ngritët mur:  
ju rroni dhe rilindni përsëri,  
siç lind nga trungu bisku i ri,  
kur mplaken edhe vdesin perëndi...  
Ju, mbrujtët e mbrojtët gjer në varr  
gjuhën e shqipes sime  
thesar.

## L A L O T I

*Kushtuar kujtimit të veteranit  
Sotir Josif Guçit nga Pogradeci,  
që i thoshin Lalot.*

Me dhjetë fyshekë, me afshin që vret,  
në Vlorën e bardhë shkoi luftëtari —  
atje tek e grishte nderi dhe zjarri —  
armikun ta hidhte brenda në det.

Çirrej e grisej Myfid tradhëtari:  
«Ç'po bëni, kardashër? Ç'po bëni, medet!  
«Bretkosën» ë kemi të dytë dovet,  
se në Anadoll ç'na iku i pari!»

Po shkoi përpara ky trimi Lalot:  
atdheut, atdheut t'i dalë për zot!  
Kërcet mitralozi në natën e hirtë

nga telat me gjemba armiku qëllon...  
Laloti vërviti gunën e dhirtë  
si urë dhe brenda fortesës vërshon.

---

Sotir Josif Guçi kish qenë murator, i mërguar në Rumani. U kthye më 1914 në Durrës, si vullnetar, me mokrarët, dhe luftoi në Rrashbull, më vonë luftoi nën urdhërat e Themistokli Gërmenjit, pastaj në Vlorë, kundër italianëve.

### **ESAT PASHA**

Kur shterri grazhdi i bab'merhum sulltanit,  
Esati gishtin kaplloqes i vuri:  
«A llokma nep? I mirë asht e gjauri!»  
dhe tasin i zgjati sërbit, junanit. . .

Për princ çifligjesh ç'i queshte nuri  
dhe vulën vuri kasapi i vatanit:  
Korçën — grekut, Vlorën — italianit,  
sinorët rrotull Tiranës i pruri.

Kur ngordhi nemci — frëngu i dha bukë  
të mbledhë kopukë bashibozukë. —  
Me satër më katër vendin e griu,

pa shkoi në Paris, imzanë të verë,  
po trim me fletë seç doli Avniu  
dhe kërmën ia flaku drejt në skëterrë.

## **EFREMI I GJINIT**

Efremi i Gjinit, renegat Elbasani,  
vetveten ç'e shpalli vorioepirot:  
Kuleta e Llasos pare kish plot,  
pra për Heladën furrë i digjej xhani.

Në Korçë brenda kurdiste komplot  
dhe hapte helmin që hidhte Junani.  
Themistokliu ish vrarë... Pra, hajvani  
pandehte se Korça kish mbetur pa zot.

Kambanat binin, meshonte dhespoti...  
Efremi mbante fjalime te Stema:  
«Shqiponjën në Korçë nuk e ze moti  
pra, burra, tyxharë, kërkoni Greqi!»  
Por kupa u mbush dhe trimi Paza Pema  
me plumb e shtriu renegatin e zi.

1959.

## **DJE DHE SOT NË FSHATIN TIM**

Dikur,  
në fshatin tim  
binin shpesh  
dyfegje —  
natën.

Dhe oxhakët ndillnin e shpinin  
krismat  
shtëpi më shtëpi.  
Dhe njerëzit, të krrusur pranë vatrës,  
në dritë pishtari,  
thoshin me ankth:  
«Këta dyfegje ranë në plot.  
Kush u vra vallë?»  
Dhe nënët pyesnin me dridhma:  
«Jini a s'jini të gjithë  
këtu?»

Dhe lajmi kobëmadh hapej, shpejt,  
anembanë  
se dikush ish vrarë në pritë,  
për gjak...  
Dhe vajtonin  
nëna, gruaja, jetimët,  
dhe njerëzit tundnin kryet,  
të pikëlluar  
për atë që ish vrarë  
dhe për ata që do të vriteshin  
më tej —  
gjak kundër gjaku.  
Po shpesh, në fshat e mbi fshat,  
krisnin batare të tëra  
dyfegjesh  
dhe binin shumë burra  
nga të dy palët;  
dhe breheshin, bluheshin, shuheshin  
fise të tëra  
të ndara dhe përqara  
në hasmëri shekullore,  
që as pleqtë nuk mbanin mend  
zanafillën.

Në fshatin tim,  
ditën dhe natën,  
njerëzit vozitnin me drojtje

në udhë pa udhë,  
nëpér shtigje të humbura, të errëta,  
nëpér gëmusha të dendura  
dhe gërxh më gërxh,  
me të vëzhguar, me të nuhatur,  
që të mos binin në pritë,  
tek priste  
dyfeku grykëgjatë.

Dhe arat mbeteshin lëndina,  
kopetë e dhenve — bështina,  
se zotërit e tyre  
nuk dilnin dot me qe e parmendë,  
me dhen, në kullotë.  
... Dhe sundonte skamja e hidhur,  
ankthi i madh pér misër e dhallë  
dhe errësira.

Në fshatin tim,  
kosa e zisë së bukës  
dhe e sëmundjes  
kositnin pareshtur  
duaj të njomë:  
fëmijë të mitur,  
djem dhe vajza të reja  
dhe burra në kulmin e moshës —  
pér një kokërr misër  
e një kokrrizë bari mjekonjës.

Në fshatin tim,  
me qindra trima sa dirsur mustaqja  
— Dhëndurë të padhëndëruar —  
dhe burra në moshë të pjekur,  
që mbanin mbi supe karvanë fëmijësh,  
braktisnin vatrën  
dhe merrnin mërgimet e largëta:  
për bukë e kripë,  
për borkhe të rënda kamate,  
që rritheshin, siç rritet orteku i borës,  
dhe linin andej, në mërgime,  
të ritë e tyre  
dhe kockat e tyre për jetë e mot,  
ndërsa, këtej,  
vajtonin nënët, nuset, jetimët.

Në fshatin tim,  
vdekja  
ish shtruar këmbëkryq  
dhe hante jetën tonë.

Tani,  
në fshatin tim,  
nuk bien më dyfegje natën  
ndër prita hasmërie.

Tani,  
në fshatin tim,  
nuk vdesin më foshnja të njoma,  
as djem të rinj, as vajza të reja,  
as burra në kulmin e moshës  
nga skamja dhe sëmundjet,  
se hovi i tyre u pre.

Tani,  
në fshatin tim,  
të rintjtë dhe burrat  
nuk marrin më mërgimet e largëta,  
se punë tek ne ka për të gjithë,  
dhe një bukë që nxjerrim së bashku  
me djersën e ballit  
nga dheu, nëndheu,  
nga moçalet e djeshme,  
nga krepi i thatë —  
këtë bukë e ndajmë bashkë  
vllazërisht,  
në sofrën tonë të madhe sa gjithë Shqipëria;  
dhe rrojmë, shtohemi, forcohemë,  
pa droje nga dita që vjen;  
dhe presim agime të reja,  
më të ndritura.

Tani,  
në fshatin tim,  
shtëpitë, rrugët, oborret, sheshet  
kumbojnë nga këngë fëmijësh  
dhe gumëzhijnë  
si luzma bletësh.

Tani,  
në fshatin tim,  
ndërtesa më e madhe, më e bardhë,  
është shkolla,  
që zhduk errësirën,  
dhe aty rriten, kaliten  
brezat e reja,  
të Shqipërisë sonë të re,  
të së ardhmes sonë  
të bardhë si drita e diellit.

Shtator, 1964.

## K E N G È

Shqipëri dy vilajete,  
në mes të dy malesh mbete  
e m'u bëre kral më vete.

S'qenke kral, qenke çiflik  
e të thënkan *Rjepublikë*:  
Myfit Beu të vjedh e t'fik.

Tirana — kryeqyteti,  
President — *Sulltan Ahmeti*.  
thonë se e zgjodhi mileti...

Kumandar Osman Gazepi,  
«Trim triumf legaliteti»,  
gjezdis me kalë si mbreti.

Paska vënë gisht Sërbia  
t'i përunjet Shqipëria,  
pa dërgoi askerë e tia.

Që nga Shkodra në Çardhaku  
kërcet mbi kurriz dajaku,  
me trimat nga Karadaku...

Zunë e qajnë male e gurë,  
qajnë brigjet e sëmurë:  
«Bobo! Vranë Bajram Currë!»

Po qan deti, po qan Drini,  
parpalitetë Shkumbini:  
Gurakuqnë e vrou Çatini!

..... : . . . .

Shqipëri, moj tri pëllëmbë,  
ngrite Evropën më këmbë:  
... Ç'të përtypnë nëpër dhëmbë.

Italia zgjati dorë,  
të hedhë thonjtë mbi Vlorë:  
vend i shtrenjtë, vend i gjorë!

1926, Selenik.

---

*Shënim:* Këto vargje janë shkruar në trajtë këngë popullore dhe janë botuar në gazeten «Shqipëria e Re» të Kostancës (Rumani), më 28 nëndor 1926, me pseudonimin «J» (Janus), me të cilin kanë dalë edhe shumë artikuj me përbajtje politike dhe ekonomike. Ishte koha kur A. Zogu qe shpallur «president i parë i Republikës Shqiptare», kur vritej Bajram Curri dhe Gurakuqi, kur Myfit Libohova, ministër i financave dhe zëvëndës ministër i punëve të jashtme, nënshkruante aktin e koncesioneve ekonomike të dhëna Italisë fashiste, ndër të cilat dhe koncesioni i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, ai i tokave vajgurore dhe i pasurive të nëntokës në përgjithësi.

## S H T A M B A R I

Punon shtambari në shtambëri  
një enë balte përpara tij.

Vjen rrrotull rrota, ay këndon,  
dhe dorëshkathët laton, laton. . .

Pa shtamba rritet: një bukuri —  
nga brumi i baltës, nga dora e tij.

përpjetë jetën me hov e merr  
dhe mrekullitë në duk m'i nxjerr:

ka poshtë thembër dhe lart qenar,  
një shtat të hedhur, një vrull krenar.

Çuditem shumë si vizitor,  
kur shoh një kurm kaq vajzëror.

«Ah qysh trillove, i them, o zot,  
një send të tillë kaq hirë plot?»

Seç qesh shtambari ndaj më kundron  
dhe dor' e tija punon, lëmon.

Hutohem shumë: «E mora vesh!  
«Ke një të fshehtë, s'e nxjerr në shesh.

«Ti ke një brumë që s'ka njeri,  
«dhe ja, ky brumë bën mrekulli;

ndaj vegjet shtambës ia ngjit ngadal.»  
Shtambari thotë: — «Ti s'di, më fal...»

«Në botë baltë ka anekënd,  
«po mjeshtëria do shpirt e mënd:

«Ta mbrujtësh baltën me dashuri,  
«nga dheu që skuq porsi flori.

«Pa do dhe punë, do dhe durim,  
«dhe doemos: kuptim, qëllim.

«Se shtambën unë s'e bëj më kot —  
«me ujë nesër do mbushet plot —

«t'ia shuajë etjen kujt mbjell a korr,  
atij që arën lëron me plor.

«Dhe kur ta ngrerë lart, për dølli,  
«të më bekojë me mendt' e tij».

... Punon shtambari në shtambëri —  
dhe arti i tija ësht' p o e z i.

Gusht, 1964,

Pogradec.

## **ARGJIRI I COLIT**

Anembanë buzë gjolit,  
gjer në Lin edhe përtej,  
kush s'e njeh Argjirë e Colit —  
të më thotë: kush s'e njeh?

E njeh vala e shkumbosur,  
e njeh juga dhe veriu,  
e njeh xhindri i xhindosur,  
domosdo e njeh njeriu.

Ah, e njohin shumë mirë  
se si dallgët nis m'i çan,  
në tufan, në errësirë  
i bje gjolit tejmatan.

«Është trim!» — seç thotë era,  
edhe vala: «Është trim!

«Do përpinqem përngahera  
«ta përpi në gjirin tim.

«Bukuritë që kam brenda  
«s'm' i ka parë asnjeri:  
«gjith» të arta e t'argjënda —  
«do t'ja fal atij, atij!

«Pa kam sheshe dhe kam male,  
«kam dhe hënën që kalon,  
«në pasqyrën e një vale  
«bardhësinë pasqyron;

«kam të Bukurën e gjolit,  
«një leshverdhë si peri,  
«që e do Argjirë e Colit  
«edhe lundrëzën e tij.

«Unë e pres që të më vijë —  
«do me mir do me pahir  
«e në gjirin tim të rrijë  
«jet' për jetë ta kam bir...»

Po kjo lundra e Argjirit  
qesh me fjalët që dëgjon,  
tejpërtej i turret virit,  
si me krahë fluturon.

«Unë e dua jetën time  
«lart mbi valë si një mbret,  
«edhe tej n'ato burime  
«kam një nuse që më pret,

«pa kam nënë, kam dhe atë,  
«që i mbaj me krahun tim,  
«prandaj sulem nëpër natë —  
«dimër, verë, pa pushim.

«Dhe ti, ujë, të më falësh  
«veç atë që vetë marr,  
«nuk më duhen dëngla fjalësh,  
«as perrinj e as thesar'.

«Dua leknëzën e verës,  
«krap, belbicë e koran  
«e prandaj s'i druhem erës,  
«e prandaj as ti s'më mban.

«Ulu, dallgë, hapmë rrugë,  
«sepse nëna po më pret,  
«ik, veri, e shporru, jugë  
«siç je shporur kaqe vjet!»

Por një ditë nga zinxhirat  
ç'u shkëput ky shkulmi plak  
edhe tundi thellësirat,  
që t'i hedhë Colit lak.

Treqind xhindër tē xhindosur  
u vërsulën anekënd,  
dhe kjo era e nakatosur  
u tèrbua dhe u çmënd.

**Qiell** e ujë u **bashkuan**,  
val' e mal u bënë një...  
«Ku na je, o trim, na thuaj»  
thirrën **xhindrit** më një zë.

«Ah, tani tē vish me mua!»  
briti dallga buzëgas,  
me rropama c'u lëshua,  
përmbi lundër u përplas.

Po nga shkumba lart mbi shkumbë  
lundr' e Colit bubutiu,  
Tërë erërat e tundë,  
krisi gjëmënë veriu.

Po as zhurma, po as vala  
nuk e trembën syn' e tij —  
Shkulmit i dërgoi tē fala  
dhe e la në kobë e zi.

Nëpër ujë, në rrëmujë,  
dallg' e bardh' kur u përplas,  
la liqenin me burbujë,  
në ranishte shkau me gas.

.....

.....

L

.....

Anembanë buzë gjolit,  
gjer në Lin edhe përtej,  
kush s'e njeh Argjirë e Colit —  
të më thotë, kush s'e njeh?

Korrik, 1948

## BALADA E ZOGUT TË VOGËL TË DALLËNDYSHES

*Irini të vogëli*

Nëna i humbi në shtërgatë, tek kish dalë për ushqim:  
mbeti zogu i dallëndyshes i mjeruar e jetim...  
Rri i ngrirë buzë çerdhes edhe pret e pret e pret,  
gojëhapur, krahëmbledhur, po askush ushqim s'i jep.  
Sa e bukur është toka, sa i ndritur është dielli,  
porse zogut të uritur sterrë e pus i duket qielli.  
Venë e vijnë dallëndyshet të ngarkuara në sqep,  
po sikush për vetëveten, po sikush për zog'n e vet.  
«Ku më është nëna ime? A mos vallë më harroi?  
Nuk e di se jam i mitur, krahë s'kam të fluturoj?»  
Ku ta dinte zogu i vogël se, përtej, nëpër stuhi,  
krahëthyer, trupmbërthyer ra e vdekur nënë' e tij!  
Ku ta dinte zogu i mitur, se në çastin kur mbaroi,  
zemra e nënës ditëzezë porsi gjëmë uturoi.  
Jo për veten, pa për foshnjën, që e linte pas jetim  
rrahu zemra e saj e djegur si buçim që vrungullin.

«Jam i vogël!» — klithi zogu. — «Unë s'mund të  
fluturoj!

«Ah, më fal një sqep dhe mua!» — iu lut fqinjës që  
kaloi.

Por as fqinja dhe as miku nuk e ndali hapnë e vet.

Juritur na rri zogu, edhe pret e pret e pret...

Erdhi nata, shkrepën yjtë, edhe prapë u bë mëngjes.

«Do të vdes! — tha zogu i vogël — Po pa rrojtur qysh  
të vdes?

Jeta është kaqe eëmbël, bota plot me bukur,  
dhe në bar, në lule e drurë gjenden kaqe eëmbëlsi...  
Ah, sikur të dal në botë, — nënën time të kërkoj!  
Të hap krahët... Po s'kam pendë e nuk mund të  
fluturoj!

Po kështu, siç jam, do nisem: nënës do t'i vete pas,  
të më sjellë rishtas jetë, të më japë rishtas gas!»

Tha kështu, dhe i vendosur, u lëshua nëpër erë:

Le të vejë ku të vejë, le të bjerë ku të bjerë!

Sa u drodh kjo zemra e mitur, zemra e tij vogëloshe,  
kur u gjend pa një mbështetje nëpër erë, nëpër  
boshe...

Iu duk sikur tundejjeta, tundej e lëkundej bota,  
dhe në trupnë e tij të brishtë rrähën dallgëza të  
ngrohta.

Dhe që lart, që nga foleja, na u gjend në një lëndinë,  
nëpër bar e nëpër fletë, nëpër lule trendelinë,  
dhe me sqepnë e tij të mitur dhen' e njom' duke  
çukitur,

gjeti miza e fulterëza — se na ish fort i uritur.  
Po kur desh tē ngrihej rishtas, nēpér erë, si tē tjerë,  
krahu i tij nuk hapi rrugë, ish i dobët krahu i mjerë. .  
«Do tē pres» — ta vogëloshi — dhe u fsheh nēpér  
barishta,  
nēpér bimëza me vesë, nēpér lule e gjethishta.  
Dhe kështu kaloi një ditë, dhe kështu kaluan dhjetë,  
gjersa penda e tij e rritur i dha vrull tē marrë retë.  
Ah, sa mirë është sipër, tē çash ajrin mes pér mes,  
t'i bjesh botës rrëth e rrrotull e sérish t'i vish foles!  
Por foleja ish e shkretë, nëna s'ishte kthyer më.  
I mahnitur mbeti zogu, kryevarur e pa zë. . .  
Pyeti lart e pyeti poshtë, gjersa një, me psherëtim,  
cicëriu me zë tē shuar: — «Zog i mjerë, je jetim. . .»  
Ish i rritur zogu ynë, po pér nënë kur dëgjoi,  
qau me lot e ngashërimë dhe vajtoi, vajtoi, vajtoi.  
Sepse nëna është e dhemsur, qofsh i mitur a i rritur,  
të ka falur jetë e dritë, të ka ngrohur, të ka ngritur.  
Dhe në rrizuall rrëth e rrrotull nuk ka zog e s'ka njeri  
s'ka në botë gjë tē gjallë, që s'e do nënën e tij!  
Si ato që hiqen zvarrë dhe ato që fluturojnë,  
si ato që çajnë ujrat — nënën kurrë s'e harrojnë.  
«Po tan? — pyeti zogu — Ç'do tē bëj unë tan?»  
«Do tē bësh siç bëjnë gjithë: do tē nxjerrësh zogj dhe  
ti!»

Ja, kështu i thanë gjithë. . . Hapi krahet fluturoi  
nēpér erë me tē tjerë dhe një shoqezë kerkoi,  
dhe e gjeti në lulishte, një tē diel në mëngjes:

veshur me fustan të gjatë, vijëbardhë mes për mes.  
Ish e bukur dallëndyshja, sulej tej porsi shigjetë —  
fërfëllim' e saj e fortë çante ajrin, çante retë.  
Dhe pranvera ish e embël, rrësk të ri kish sjellë maji,  
dhe nga bota ishte zhdukur helmi, dhembja edhe vaji.  
Van e ardhë nëpër erë të dy bashkë krah për krah:  
ai poshtë, ajo poshtë; ai la, ajo më la.  
Kështu nisi dashuria nëpër kopshte, nëpër erë,  
nëpër pjergulla me vesë: si ngaherë, kurdoherë.  
Edhe bënë ve të vogla, edhe çelën zogj të mitur —  
zogj të bukur, pupëlbutë, por makutë, të uritur.  
Sa i donte zogu zogjtë! Ças për ças me sqepin plot,  
kurrë s'dinte ç'ish mërzia dhe të ndenjurit më kot.  
«Unë e di, moj shoqe fqinjë: vogëloshi do ushqim,  
jam i rrahir nga e zeza, se kam qënë e jam jetim,  
do mundohem që fëmijët të mos shohin varfëri  
e të rriten të gjëzuar, me shëndet e lumtëri».

\* \* \*

Ja, kështu vazhdon kjo jetë, dit për ditë e ças për ças:  
ka mjerime, dëshpërime — po na ka dhe jetë e gas.

1948

## PRANVERË NË ENKELANËN E RE

Re të lehta udhëtare  
rendin qiellit të kulluar,  
duke endur shkarravina  
fushës son' të posazgjuar.

Nëpër ara nis paloset  
plis i zi që e hodhi plori  
dhe kumbon në katër anët  
këng' e re që hap motori.

Dheu i djerrit bukëdhënës,  
i thërmuar, bukëvale,  
nis të skuqë nëpër pllajat,  
gjer në kreshtat, lart në male.

Vreshtave përballe diellit  
po loton hardhi e prerë:  
ja kthen rishtas lëngun tokës,  
si çdo mot, kur vjen pranverë.

Punë, paqe anembanë,  
Rreh çekani, bije bareja,  
Enkelana e rilindur  
veshi petkëzat e reja.

Në Gurkuq, nga zemr' e dheut,  
tek lëngonin pasuritë,  
krahu i fortë i minatorit  
nxier hekurin në dritë.

Mal' i Thatë kryethinjur  
mbi lijer po llamburin,  
dielli i ri e rrezeartë  
gjith' dëborën nis ia shkrin.

Në prehër i gurgullojnë  
prrënjk të shumtë shkumbëtarë,  
duke zbritur tatëpjetë —  
bujmëdhenj e këngëtarë.

Ja përpin lijeri i kaltër  
i Lyknidës s'Enkelisë  
dhe ja fal të gjitha bashkë  
Drimit trim të Dardanisë...

Në kënetë kallmri i njomë  
farkëton shpatoren fletë

sipér ujit tē përgjumur,  
që i fal blerim e jetë.

Prapa tij, ndér fellétira,  
stiset gonxha e zëmbakut,  
që ia merr tē gjithë ngjyrën  
edhe borës, edhe gjakut.

Mbi shelgjishtet, buzë lumit,  
valavitet si shami,  
flatr' e bardhë e lejlekut,  
që u kthyë përsëri.

Prej së largmi dallëndyshet  
si shigjeta: ardhë, ardhë!  
Nëpër kodrat, gjer në majë,  
lul' e mollës zu tē lbardhë.

Bubullojn', kur shtje rrufeja,  
malet përkëtej Shkumbiut.  
Mos u trembni, se dhe malet  
nuk i tremben kurrë shiut...

Pa në sjelltë ndonjë vesë,  
porsi loje do kalojë  
dhe pas vesës gjithë vendi  
fort më fort do gjelbërojë.

Er' e athët e gështenjës  
tatëpjetë zbre<sup>t</sup> e rreh  
dhe me barin e ugarit  
Enkelanën po ma deh.

.....

Kaqe ngjyra n'hapësirë,  
kaq stoli në vreshtë e arë,  
kaqe amza, kaqe tinguj —  
cilin të përmend më parë?

— Heshtni... Del trimosh ferraku,  
ja merr këngës e ia thotë:  
Ah, e shoh si kjo krahinë  
s'ka e s'ka në gjithë botë!

## NJË NDAJNATË NË POGRADECIN E VJETËR

Me opinga zbret ndajnata,  
mos e ndejnë qentë e fshatit,  
duke matur çapnë e lehtë  
pas gjilpërës të sahatit.

Sapo ra, iu shtrua punës,  
me ngadalë dhe pa zhurmë:  
mbi gështenja e kënetë  
hodhi gunëzën e murmë;

meqë hëna ish e brishtë,  
s'ndezi llambën pas dëshirës —  
gjithë kodrat rrëth e trottull  
iu përulën mugëtirës.

Vetëm ylli vogëloshi  
nuk pranoi t'i falet fatit:  
nëpër terr e ndezi eshkën,  
me të shkrepmen e masatit.

Dhe pas vravave të tija,  
ballin ngritur kundër erës,  
vijnë lundrat që nga viri  
plot me leknëzat e verës.

..... Po, befas, me kujë e bujë,  
si përrenj me arra gunga,  
vijnë qerret nga luadhet  
nëpër rrugë vranga-vrunga.

Dhe me qerret e me barin  
sos një tufë me gjinkalla,  
që ia krisin e ja thonë  
sa lëkundet gjith' mëhalla.

Përnjëmend të tërë fshanë  
ma mbështolli afshi i barit,  
ledhatonjës... turbullonjës,  
porsi zemra e beharit.

pa në prak, tek janë mbledhur  
edhe prehen nusëria,  
një nga një çliruan gjiret  
që të rritenë fëmija.

Dhe tek rrinë e tek pinë,  
një nga një ç'i mori qorri —

orri gjumië, që kish ardhur  
e ish fshehur ne oborri.

... Ç'është vallë, ç'është vallë?  
Ja, vështroni nëpër erë,  
s'di se kush po vjen nga ferrat  
duke tundurë fenerë!

— S'është gjë: një xixëllonjë  
vjen të thotë sa më parë:  
«Gjith’ ata që mbollën grurë,  
të gatisinë grunarë!»

... Tingër-tingër tingëllojnë  
tërë zilet e kopesë  
e m’i prin gjithnjë përpara  
sisëpleteja kobeshë;

dhe më sjell për vegjelinë  
që nga malet, për matanë,  
si të fala e si ftesë —  
përmbi bri një degë thanë.

Pa m’i del ma pret përpara  
vetë çocër kapedani,  
që ta sjellë me të mburrur:  
«Unë u ngjita në Rëzhani!»

Gurgullon me gumëzhimë  
shkumb' e qum'shtit në lagjinë,  
që ma mban me jetë e forcë  
vegjelinë . . . pleqërinë.

. . . Namëta, me zhurmë e gjëmë,  
sikur turren qentë e stanit,  
tatëpjetë nga Gur Topi  
zbresin mushkat e çobanit;

sjellin gjalpë në kacekë,  
sjellin djathë me mëshore,  
dhe mbi drrasat, që nga Sharra,  
mjaltë t'egër në koshere.

Pa kjo shirra e bredhit tonë  
me bar fusha nakatoset. . .  
E bekuar qofsh, moj tokë,  
që thesari nuk të soset!

. . . Çlodhet shata e mistria,  
çlodhet dora e bumbyer,  
veç mulliri i tim gjyshi  
rrotullohet i rrëmbyer..

Po u lodh dhe plaku i thinjur,,  
ndali pendën me pengore

dhe buçima përnjëherësh  
seç u tret si pllaz dëbore.

Dhe plakosi qetësia:  
gjithë fshati ra në gjumë,  
u platisht dhe shpeshëria —  
nëpër shelgjet, përmbi lumë.

Përmes heshtjes kroi ynë  
ja merr këngës e avazit  
pa ia mban, siç e do radha,  
shtruar-shtruar rrem' e jazit... .

Lart në qiell ç'iu thye boshti  
querres t'atij zotit Kumtër  
edhe kashta e lëmenjve  
mbeti varur në një kulpër... .

Ah, të kesh një cfurk të gjatë  
që ta mbledhësh në mullarë,  
mjaft e ke për tërë dimrin —  
për të mbajtur gjënë e gjallë.

Pak më tej, Arush' e madhe  
u hodh poshtë, nëpër grenda:  
Oh! makutja! Kishte etje  
ra në gjol e tëra brenda!

Përpëlitet, llapashitet  
në të thatë pér të dalë,  
dhe ia merr nga Qafa e Thanës,  
bje më not valë më valë.

... Sa ia ndjeu unapit erën  
seç u mek ky Mal' i Thatë...  
Fëshfërin nxituar fletën  
ziliqari plep i gjatë.

Dhe lijeni i përgjumur  
nis merr frymë thellë-thellë,  
se i shkon mbi faqe era,  
me parmëndë pér të mbjellë.

.....  
.....  
.....  
.....

Qetësi në lartësira,  
qetësi në thellësira  
zemr' e natës mbretëron,  
ylli i dritës xixëllon...

## PRANVERA E PLAKUT

Ka zbritur, s'di se si, një dritë e hollë,  
që mund ta zesh me dorë. Dhe s'di vallë  
se g'ësht' ky pah i bardhë përmbi mollë  
dhe pse çdo gjë më duket si në prallë.

As qelli s'ësht i pari: u bë m'i lartë,  
dhe vjen, që s'di që ku, një erë plisi,  
gjësend që më përmend pelin e mjaltë...  
«S'merr vesh? — më thonë. — Pranvera nisi».

Këtë e shoh dhe unë... Ja, kërmilli  
ka dalë e ngrohet nëpër ferra,  
ja dhe shelgjishtet, ja dhe tërfili.  
Vërtet e kini? Na erdh pranvera?  
S'di si të them, ky mot po vjen së voni.

Po prapë nuk besoj: gjith' pllajat zbardhin.  
Po bie dëborë! Ja tek qëmton: vështroni!  
Sa keq më vjen për bimët. Do të mardhin.  
S'di si të them, ky mot po vjen së voni.

S'është dëborë? Kajsitë e mollët çelën?  
Ato zbardhojnë mbi kodrë e lumë?  
Prandaj, prandaj... sot zemrënë ma velën.  
E shoh se ne sivjet do kemi pemë shumë...

Ah, s'di se ç'kam... Më duket se jam dehur.  
Do mbështetem pak në drurin e një dardhe  
dhe sytë do t'i mbyll...

Tani jam prehur:  
Të shoh, të ndjej, pranverë.  
— Mir' se ardhe!

## **PRANVERA E QERSHISË SË VOGËL**

Nuk di se kush... S'do mend një dorë vëngër,  
ia preu qershisë fustanin fort të gjatë.  
Modistja, duket, s'di të marrë matë:  
ja derdhi frullat poshtë, gjer në këmbë.

Tani ajo pret dhëndrin në kraharuar  
dhe rri, si nuse, me duvak, e mitur —  
pa në nxitim e sëpër, duke pritur,  
haroi të lajë kokën e shkumbuar.

Ah, kjo i falet: e vogël është e s'di..  
Pa ja, vështroni tej: porsi shigjetë,  
na vjen një dallëndyshe e vetë  
dhe erën çan si shpatë dhimisqi.

## PLEPI DHE QERSHIA

J

F a b u l

— Më sheh a nuk më sheh?  
Gjer lart në re  
majën time ngre!  
Jam kryelartë dhe madhështor,  
mbi gjithë drurët perandor.  
Por ti  
je për të qarë, moj qershi,  
a si të thonë, sepse as emrin s'ta di.  
Un jam fisnik  
edhe kreshnik,  
si gjithë farefisi im,  
pa më të voglin përjashtim —  
dhe madhështia më ka hie. . —  
Kështu një plep i mburrej një qershie  
që rrinte e ngarkuar plot  
me pemë, si çdo mot.

Qershia i tha:

— Ti pemë bën, o im vëlla?

Qeshi plepi: — Hahaha!

Dega ime pemë s'ka!

Jam perandor dhe madhështor. —

Qershia prapë i tha:

Më mirë thuaj se je plep,

dru i keq, që pemë s'jep,

ushqimin tokës ja merr kot

dhe kot ti rrithesh mot për mot.

Unë e kthej atë që marr,

dhe shkoj gjithënjë përmbi kandar;

në pranverë, kur lulëzoj,

vendin gjithë e zbukuroj,

njerëzinë e gëzoj,

pastaj nxitoj

të pjek më shpejt pemët e mijë

se presin pa durim fëmija.

Kurse ti, o plep qyqar,

s'je për kosh as për hambar,

dhe as i mirë për në zjarr,

se drunë ti e ke të lehtë

siç je vetë...

Ti, o plep,

as hije për t'u çlodhur s'jep,

se lëkundesh për gazep;

ti tërheq vetëm rrufe

dhe sorrave u jep fole,

se dhe ti si sorrat je! —

Pa mbaruar fjalën mirë,  
na shkon i zoti me të birë  
dhe bisedojnë,  
kuvëndoijnë:

— Ky plep i gjatë s'na hyn në punë:  
T' i vemë sharrën, t'i marrim drunë  
dhe qershisë plot me pemë  
dy-tri furka do t'i vemë.

1948

## PO TË VDES NË DHE TË HUAJ

Po të vdes në dhë të huaj  
— shortë mërgimtari —  
të ma bëni varrin tim  
ku do bje së pari.

Pa një grusht nga toka jonë  
— baltë nga balta e vetë —  
të ma sillni e ma vini  
drejt ne zemra e shkretë.

Se kjo balta e vendit tonë  
mallet do m'i shuaj,  
s'do më duket fort i rëndë,  
oh, ky dheu i huaj.

E të vini m'i thoni  
usaj nënës sime:  
zi mos qajë, zi mos mbajë  
po asnjë thërrime.

Se m'i lumtur jam i fjetur  
se sa i mërguar,  
mot pas moti arratie,  
zemër copëtuar.

## TI MORA DUART

T'i mora duart ndér duart e mia  
dhe sytë m'u mbushën plot dritë,  
që ngjiste me dritën e hënës —  
e krittë si drita e hënës.

t'i mora duart ndér duart e mia  
dhe brenda tyre humba i téri  
si nëpër dete të krittë —  
si lundér ndér dete të krittë.

t'i mora duart ndér duart e mia  
dhe syresh piva me atje  
si prej potiri t'argjëndtë —  
kungatën e dritës së hënës  
të derdhur ndér dete të krittë;

t'i mora duart ndér duart e mia...

28 prill, 1946.

### MË DI, A NUK MË DI...

Më di a nuk më di se qaj,  
më di a nuk më di se vuaj  
në orët e thella të natës,  
kur ngrihem i çmendur të shkruaj —  
me gjakun e zemrës të shkruaj.

Më di a nuk më di se agimet  
më gjejnë pa gjumë në shtrat,  
me shpirt të shkretuar nga dhembja,  
e dhimshëm i pres perëndimit,  
me ankth i pres perëndimet.

Më di a nuk më di se sot  
u drodha kur pashë pranverën,  
që zbriste me flladet e prillit,  
e ëmbël siç ishte qëmot,  
e hidhur siç ishte qëmot.

Më di a nuk më di se qaj,

më di a nuk më di se vuaj  
në orët e thella të natës,  
kur ndjehem ngajeta i huaj,  
nga vendi i lemjes i huaj.

Më di a nuk më di. . .

Shtator, 1942.

**BJE SHI...**

Bje shi, Adrianë,  
bje shi i qetë mbi qytet,  
shi që më bluan e më vret,  
dhe s'di se ku të shkoj  
nëpër Tiranë.

Të kërkoj, Adrianë,  
me ankth nëpër qytet' në e shkretë,  
kur shtrydhen retë  
dhe diell s'lind e s'perëndon  
përmbi Tiranë.

O sa çudi, Adrianë,  
të duash të mos jesh njeri,  
dhe gurëve t'u kesh zili, —  
se gurët s'vuajn' kur bje shi  
përmbi Tiranë!

## **ENDËRRIMET E NJË NATË PRILLI**

Ankthi i pritjes më ka shembur,  
po gjithmonë rri e pres,  
gjatë natësë së nëmur,  
gjer të zbardhet mëngjes.

Ah, q'm'u ndal akrep' i orës!  
S'ka gjësend: do pres një gjel.  
Ah, q'm'u shojt kandili i dorës!  
Nuk prish punë: hëna del...

Pesha e lodhjes mbi kapakë  
më rëndoi, pastaj u ngrit.  
Sigurisht, do ngrihem prapë,  
veç një grimëz do dremit.

... Por befas, nëpër një rrezë,  
ajo vetë ja tek vjen  
dhe me kryet në tryezë  
të ndërgjumur po më gjen,

Dhe ç'm'u mbush e tärë dhoma  
plot me amëzën e saj:  
luleshtrydheza të njoma, —  
s'ka më ankth e s'ka më vaj.

Është aty, apo më duket?  
Jam aty, apo nuk jam?  
Ndritin flokëzat mbi supet,  
ndrit dhe guri më gjerdhan.

Nga njëmijë e njëqind fjalë  
që kam grishur t'i rreshtoj,  
hov asnje nuk do të marrë —  
e vështroj dhe e vështroj... .

«Jam vonuar?» — pyeti vetë.  
«Jo, asfare, po më fal,  
se më erdhe këmbëlehtë  
e nuk munda të të dal... .»

Dhe i marr duar ndër duar  
dorëbardhëzës sedef,  
i përpj i përmalluar  
syn' e tretur në gjergjef.

«Qysh më qesh kaq shumë fati  
të të kem në krahun tim,  
e ky ankthi im qysh pati  
kaq të ëmbël përfundim?

Unë i mjeri kot u tremba,  
thashë s'vjen, ndaj po vonon.  
Er'e gjirit tënd ndër rremba  
valë-valë më përshkon.

Kurmi yt porsi pranverë  
më jep jetë nëpër dej...»  
M'u shkëputë përnjëherë,  
hape perden tejpërtej.

Edhe hëna e brylltë rrođhi  
brenda dhomës, si fildish,  
hov'n' e këngës seç ma vodhi,  
ritmi i hedhurë m'u prish.

S'ka gjësend: do ta lidh fillin —  
me fill rrezesh ngjyrëar  
e do ftoj për ndihmës prillin —  
turbullonjës vjershëtar.

... Po qysh ike, qysh u trete?  
Ku më je? O ku më je?  
Të kërkoj ndër qiej e dete —  
dhe s'të gjej, jo, nuk të gje'.  
.....

Oh, si lot me zemrën time!  
Balli nisi e më dhemb.  
Kaq të bardha ëndërrime,  
ti më stis e ti më shemb.

## **NISJE PËR MËRGIM**

Ah, këta male me dëborë,  
që mbajnë qiellin atje la,  
si nesër nuk do t'i gëzoj,  
si nesër nuk do t'i kaptoj;

dhe këto fusha, ku pranvera  
ka derdhur grushte me stoli,  
si nesër nuk do t'i kundroj,  
si nesër nuk do t'i këndoj;

dhe këtë dorë kaq të krirtë,  
që më çmend e lumtëron,  
për jetë nuk do ta harroj,  
sa do të rroj, sa do të rroj.

## TANI QË SHKUAN...

Tani që shkuan kaqe vjet  
dhe u dynd dëbora mbi kreishte,  
i mekur veten time pyes:  
ishte a s'ishte?

Apo pat qenë një vegim,  
që del n'agim nëpër zallishte —  
dhe ky vegim ca sy të zez  
kishte a s'kishte?

Kaluan vjetët me rrëmbim...  
Dhe pres i mjerë, i sëndisur...  
Më fal, lexonjës, të të pyes:  
që ku e pata nisur?

1965.

## P A N J A

Në pranverë gjithë drurët  
na u veshën me blerime  
dhe së largu midis tyre  
nuk dallohen një thërrime.

Por, sa fryu fllad' i vjeshtës,  
gjeth i panjës zu ndryshoi,  
pa kjo ngjyrë nga të gjithë  
dalangadalë e dalloi.

Rri mahnitur mbarë pylli  
dhe vështron, vështron, vështron,  
se kjo panja fletëndezur  
si flamur i kuq valon.

13. 12. 1966.

## P R I L L I

Shtatë male hodhi prilli  
prilli magjistari —  
dhe kudo ku këmbën vuri  
mugulloi bari.

Varet dega gonxhefryrë  
si kllongjir mbi krua,  
kup' e qiellit tē kulluar  
kulmesh u lartua.

Sa i hollë u bë flladi,  
sa e gjerë fusha...  
Pa i hapën zemrës sime  
anembanë usha.

Ec mbi tokë dhe më duket  
se më dehu era:  
er' e prillit magjistarit,  
tek gufon pranvera.

29. I. 5 — II. 1967.

## DIL NË PRAK

Dil në prak të shohësh hënën  
qysh end brymën gjer përdhe  
dhe qysh shqet e buzëqeshur —  
lundërtare nëpër re;

dil në prak të ndjesh puhinë  
erëmirë, që flladit,  
edhe vesën mëngjezore  
bar e lule tek ujit;

dil në prak se filomela  
ndër blerime nis këndon,  
gryk' e lumit rri nemitur  
edhe trillin ja dëgjon.

... Ti nuk del. I vetëmuar  
pres më kot dhe ëndërroj,  
nuk ve re se hën' e bardhë  
që qëkuri perëndoi.

10. II. 67.

## HËNA E HUMBUR

Hëna mbeti mbrëmë jashtë  
lakuriqe nëpër re. —  
Sot u ngrita që me natë,  
e kërkoj, po nuk e gjej.

Kushedi, e joshi ndofta  
një poet a këngëtar,  
a e lidhi qafë malit,  
në pusi, ndonjë kusar.

Do të shkoj t'i qahem plakut,  
të dërgojë kallaus...  
... O, s'më duhet, se e gjeta  
kredhur brenda në havuz.

Rri e mpitë, rri e mardhur,  
po s'ka gjë: un do ta nxjerr  
dhe ta hedh si top dëbore,  
që të endet nëpër qiell.

Filluar Vlorë  
totor 1963. Mbaruar  
Tiranë, prill, 1967

## PRANVERA E BAJAMES SË VOGËL

Gjatë bregut t'Orikumit  
fryu puhiz' e deteve,  
hën' e plotë rrezargjëntë  
shtroi brymë neteve.

Klithi cerri vogëloshi  
kredhur nëpër ferratë:  
«Hej, dëgjoni! Erdh pranvera,  
blegërijnë berratë!»

Nën Kaninë, në një brinjë,  
e dëgjoi bajameja:  
«Ah, së shpejti, me pranverën  
sos dhe dallëndysheja,

Do t'i dal ta pres e para —  
nisur dhe stolisurë,  
ndonse jam e vogël shumë,  
vashëzë e miturë».

As nuk priti, nuk e zgjati:  
Bruf! — i çeli luletë,  
që nga mesi i janarit,  
dinga mbushi degëtë.

Gjithë pemët ç'e kundrojnë  
shumë të habitura:  
«Pse mëngoi, si guxoi  
shoqëza e mitura?»

Vallë s'di se shkurti e marsi  
ndjellin fërfëllizatë?  
... Ç'e gënjeu er' e ngrohtë,  
Ç'e gënjen puhizatë...»

Qielli ishte qelq i kthjellët,  
derdhte dielli rrezetë —  
gjatë gjirit t'Orkumit  
kuqëlonin luletë.

Shkuan ditë, dhe, papritur,  
brofi er' e maleve —  
me rrëmujë dhe burbujë  
iu vërsul bajameve.

Tunden e katosen degët:  
hov' i fërfëllizësë!

Shkunden lulet kuqërreme  
nga duhi e ngricësë.

Thonë pemët anembanë:  
«E pësoi e mitura,  
siç pësojnë gjithëmonë  
vajzat mendjengritura...»

Mbushet bregu edhe deti  
plot e plot me petëza —  
po ndërkaq bajam' e vogël  
paska lidhur kokërrza.

Edhe kokërrzat s'ja shkuli  
dot duhi e shkurtitë;  
pa m'i rriti, m'i ngurosi  
buzës së shëmbitritë.

7. XII. 66.

## PRANVERA E PLEPIT PLAK

Vjeshta ja skuqi fletën, ja thau, ja zhveshi.  
Dimri e rrahu me tufane.  
Degët dhe degëzat e tij mbetën lakuriqe  
në qiellin e cingërimtë,  
si ca pezhishka të errëta merimange.  
Përmes tyre kalonte e lirë  
kosa e urtë e hënës së rirë,  
depërtonin tejpërtej  
gjilpërat e yjve  
dhe nxinin kobshëm  
çerdhet e galave gërnjëtare —  
mikeshave të pandara  
të plepit plak,  
që përkundeshin në erë,  
si djepe shtrigash dhe kukudhësh.  
«Vdiq, vdiq  
plepi plak palepaku!»  
Por ja,  
me marsin,

anembanë

nisi të ndjehet frysëmarrja e pranverës,  
që lau dhe shpëlau me dritë  
trungun dhe degët baloshe  
të plepit plak.

Dhe dalngadal, dalngadal,  
pezhishkat u mbushën plot bulëza të blerta.

Plepi plak i ushqeu me lëngun e dheut,  
që e thithi, e ngriti, e ngjiti  
nëpër palcën e tij  
lart e më lart.

Dhe një ditë  
nga bulëzat e tij shkrepën shkëndija blerimi  
që u bënë  
gjethëza të brishta si zemra.

«Çpo bën kështu, o xhaxho plep plak?

Ne të dinim të vdekur...»

«Prisni pak, prisni pak,...» — tha plepi plak.

Pa, një ditë,

gëluan gonxhat, u frysë, u hodhën  
si gjire vajzërie.

«Tani?» «Jo, prisni pak, prisni pak»

tha plepi durimtar

dhe vazhdoi t'i ushqejë me lëngun e dheut,  
me dritën e diellit,

t'i mbajë fshehur ndër gjethëzat e tija.

Dhe një ditë,

një fllad i kaltër

bëri të plasin gonxhat e tryn  
dhe përnjëmend  
filluan të vallojnë në erë  
flokë të bardha dëbore,  
lart e më lart  
në qiellin e kaltër,  
të bien mbi faqen e lumit,  
në erë,  
mbi pullaze,  
afër e larg.

«Ç'është, ç'është? A mos u kthye rishtas dimri?  
Plepi plak qeshi nën mustaqet e bardha.  
«Jo, s'është dimri,  
po pushi i pemës sime,  
që do të zbardhë gjithë botën».

## KROI I KODRËS

Sa shumë ngazëllime sillte Kroi i Kodrës  
në këtë mëngë të dheut!  
Për hir të tij  
rritej dhe harlisej  
një botë e tërë blerimesh  
dhe lulesh erëmira.  
Pa brenda kësaj bote —  
popuj të shumtë zogjsh  
ngrinin qindra lahuta, mijëra fyej  
dhe flisnin me tinguj larushë:  
«Mos shko!  
Rri edhe pak, rri edhe pak!»  
Dhe rrije,  
se të mbante tingulli i këndshëm, hija, puhia,  
që flladitnin, prehnin, ngazëllonin.  
Pa natën,  
kur drita e hënës bëhej lëndë férmonjëse,  
tingullhollë,  
që endej e lëvrinte mbi të brishtat fletishte,

zbrisnin vrundull sutat kömbëlehta  
dhe etjen e shuanin me ujin e gjallë  
të Kroit të Kodrës.

Por ja, papritur,  
amëshim pas amëshimi,  
erdhi një mot i nëmur shumë:  
shteroi Kroi i Kodrës,  
u vyshkën e u vdarën lulet erëmira  
u ndryshkën e u thanë blerimet  
dhe vjeshtë pas vjeshte, verë pas vere  
dual jashtë  
në pah  
brinjët shëmtakë të shkëmbit  
si rebra kuajsh gërdallë —  
bij të mortjes.  
Shkuan e vanë zogjtë këngëtarë  
megjith fyej dhe lahuta —  
dhe vendin e tyre e zuri  
hardhuci i murmë,  
mik i gurishtave,  
që çeli zogj zvarritës  
si hieroglife egjiptiane  
në brinjët e thata të kodrës.  
Nuk ardhën më dashnorë,  
Nuk zbritën më sutat.  
Drita e hënës u kthyesh si cifël qelqi  
në karpat.

Gjithë miqve rreth e qark  
u pikoi në zemër,  
por s'qanë dot,  
se s'dinin të qanin,  
se s'kishin lagë.  
Vetëm shkëmbi stërmadh, i myshkët,  
biri i amëshimeve,  
vështroi,  
ofshoi  
dhe nga dhembja  
u ça më trish  
dhe lotet i vanë kalivare.

Ata rrodhën në prehërtë kodrës  
dhe laga e tyre jetëprurëse.  
ringjalli blerimet e lulet,  
që ndollën rishtas  
popujt e shumtë të zogjve këngëtarë  
dhe sufat këmbëshpejta.  
Ata erdhën të shuajnë etjen  
në kroin e ri të karpët.  
Kjo është  
mrekullia e pikës së lotit.

## PRANVERË NË MYZEQENË E RE

Fluturoi një lejlek mbi të djeshmin moçal  
edhe pa, q'atje la, plëng të ri, bukuri...  
U habit edhe tha: «Jam a s'jam në Shqipëri?»  
Mbi kanal, në një plep, mbajti krahët, u ndal;

dhe q'aty syt' e tij qerthulloi qark e qark:  
Tejpërtej, gjer në det, fush' e re vlon e vlon,  
një traktor bujëmadh turfullon, bubullon,  
djem e vajza në punë nxitojn' varg e varg.

Pak më tej fshat i ri ndër blerim zbardhëllen;  
që nga gjir' i kënetës s'di qysh u javit.  
E përshkon rrug' e shtruar përmes, si shirit,  
dhe ndër ledh, në livadh, mriz kopeje me dhen-

Kodr' e zveshur gjer dje fund e krej seç u vesh  
me bajame, kaksi dhe stoli: lule plot.  
Bujkurob i dikurshëm tani është zot;  
dje: fytyrëcfilitur, sot: gazmed buzëqesh.

«Po ç'u bë uj'i zi që gjer dje më ushqeu?»  
Zogu tha: «Këtu s'ka as moçal as shavar...»

Jo e jo, s'ish kështu gjith' ky truall shqiptar!  
Moti di se ndryshon, po s'ndryshon uji e dheu!»

... Rri i mekur lejleku në çerdhen e tij,  
sypulitur sodit këtë botë të re.  
«Do të shkoj — tha në fund — një vend tjetër  
do gjej  
me kallam e shavar, me moçal-shkretësi».

Hapi krahët e bardhë i bardhi lejlek  
edhe vrundull u sul mbi të djeshmin moçal:  
Kuqelon një pullaz, furfurin një kanal,  
tek kalon uj' i jetës me vrull shteg më shteg.

Kaltëron syth' i Thanës i futur në thark  
t'asaj pendës së lartë me gur e beton,  
peshk-argjëndi përbrenda shëndrit ndaj gëlon,  
kurse pun' e gëzuar kumbon rreth e qark.

Dhe më tej, rrëzë kodrash, liqerë të rinj.  
vezullojnë nën diell nënë qiell pranveror.  
Mbi ta shkrep rrez' e artë si gur me uror  
dhe lot foshnja e vogël me qengjhit kërthinj.

«Nuk do shkoj!» tha lejleku pasi rrotulloi  
gjithë tokën e blerët të vendit të ri,  
asgjékund nuk do gjej kaq e kaq bukuri...»  
Dhe një çerdhe të re bregut t'Thanës ndërtoi.

## RRJEDHIN LUMENJTË

Poemë ilire

Rrjedhin lumenjtë - e gjerë ujëshumë  
ndër caqet e botës së lashtë ilire —  
së Epërmes, së Mesmes dhe së Poshtmes:

Stërmadhi Danouv valëvezullonjës,  
që mban mbi faqe flluga peshérënda,  
dhe zurret mes tokës së sheshtë panone,  
përbrenda-së Epërmes Ilire,  
tek enden grigjet ndër dete kullotash,  
të dlira si era që rreh mbi rrrafshina;  
fushori Drav. dhe begatori Sav,  
që fill merr nga visi i fisit japod,  
dhe sulet drejt Sirmit, drejt Singidunit,  
pa udhës njom trojet e buta breuke  
dhe fushat myze, skordeste, triballe  
drithëbegata, dhe thith në shtrat Eneun.

dhe ruset ndër shkrepë, pa hidhet hovshëm  
në gjiun kundruall Korkyrës së Zezë;  
rrjedh Atesi i kthjellët, pjellë liqeri  
malesh të lartë, ushqyer gjithmonë:  
dimrit me borë dhe verës me akull;  
rrjedh Angri vraponjës, Brongu vërshonjës  
përafër kufive të Thrakës motër,  
rrem i të njëjtit trung të strëmotshëm,  
që lindi dhe rriti gjith bijtë e Ilirit;  
rrjedh vrullmadhi Drillon, pjellë e Lyhnidës  
së kaltër të Enkelisë së bujshme,  
përçan lugjet bregthepisur penestë,  
çik rrafshat dardane, krepat pirustë  
dhe vrundull turret në brigjet rudine,  
rrëzë kështjellës së lartë të Lysit  
dhe Skodrës Kreshnike: karpa mbi karpa,

bregut t'liqerit të bukur Labiat;  
rrjedh Aks shkumbëbardhi, rrjedh Erizoni —  
bij binjakë të Paionisë së madhe,  
dhe Strymoni, që lag të njëjtin truall  
të fisit paion, të moçëm sa toka,  
që luftë kish bërë, krahas me thrakët,  
qikonët dhe pellazgët larisianë  
dhe me shumë popuj të tjerë vëllezër,  
në mugëtirat e kohës prrallore,  
në Ilionin e shenjtë dardan,  
kundër filive makute akeje,  
gjithmonë tinzare dhe besëpakë,  
vërvitur kobshëm me flluga të shumta,  
shtyrë nga cmiri, tërhequr nga preja;  
rrjedh Ardaksani albanoi, Genusi  
shkumbonjës i Kandavisë pyjore:  
rrëmbyeshëm çajnë shtigje ndër gëmbra  
dhe dynden e shtrihen në lyme të buta,  
ndër ishuj të veshur me drurë të gjelbër:  
parajsa për shpesët dhe kafshët e egra;  
rrjedh Ausa gjëmonjëse, Akeronti  
thesprot dhe i vrullti Thyam mollos,  
Arakthi kasop, lumë i pagjumë,  
cak dhe prak i stërlashtë historie,  
që ndan Ilirinë e Poshtme, Epirin  
bujëmadh, nga larushitë helene  
gjakpérziera me pinjojtë e Ilirit,  
shtrirë gjer poshtë Larisës pellazge,

në zemrën e Heladës së moçme.

Rrjedhin e rrjedhin lumenjtë ujëshumë  
brenda suazës së botës ilire:  
së Epërmes, së Mesmes dhe së Poshtmes. . .

Pesë dete përpijnë lagën e tyre:  
Ponti, Egjeu dhe Deti i Thrakës,  
Joni shumë i qetë, vëllai i Adrias  
ishujshkëmborë, dhe vetë Adria,  
gji stërmadh ilir kllaposur suazës  
tribrigjëshe të Ilirisë së madhe  
dhe hapur poshtë, mes Keraunëve  
e dheut të tejshëm të Mesapisë,  
motër e Japygisë dhe Daunisë —  
me dhjetra e dhjetra fise ilire  
shtrirë në gjithë Saturnian e lashtë  
dhe tej e tutje në viset latine.

Lartohen hovshëm malet krenare  
drejt qiellit të lartë shumë të kaltër:  
Alpet e Karnit me guna të bardha,  
Okra japode, limer guximtarësh,  
karpat e Istrit, që zdrypin pingulthi  
në detin e thellë. tallazemadhin,  
që lag e përlag mbi njëmijë ishuj,  
shkëmborët liburnë, kreshtorët dalmatë  
me Adrin e brinjtë plot gjah të begatë,

vargmalet autariate — çerdhe trimash  
të papërkultur, gjithmon luftëtarë,  
karpat ardiante, brinjat labiate  
njomur të gjitha me gjak kryengritësish,  
Skard kryebardhi, që çjerr retë e qiejtë  
me krepat e zgripët — strofulla bore,  
Kerauni i rreptë, tmerr për detarët,  
baloshët Albanë, çerdhe shqiponjash,  
që shqyen e thyen skota të shumta  
të dyndura nga stërfundet e botës;  
Tomorri thinjak, thurak i Dymalit,  
Shkarrzimet kandave varur mbi quka  
lugajash, varr për dyndësit e huaj  
dhe dasharetët plot tufa pëllejash,  
Thatona e gungët, përballë faltore  
së Thanës gjahtare, mbrojtëse grigjesh,  
së cilës ilirët i sillnin flira  
të majme, shuar me verë të fortë;  
lartohet Barni i Ligerit të Bardhë,  
që ruset tej, n'fushëtirën lynkeste  
të njomur me gjakur e mbret Bardhylit,  
qymyrtarit të urtë, trualldashësit,  
në luftë me Emanthinë gjysmëilire;  
ngrihet Pangajoni, i pyllti Orbel  
Paion, me vargje liqerësh të shumtë,  
renditur bukur: rrüaza të kaltrë,  
tek' kishin banesat paionët e lashtë;  
Tomäri i shenjtë, që mbañ në prëhër

Dodonën dimërmadhe, ku kish stisur  
selinë e tij të parë Zoti i Dushkut,  
zanafilltari i gjithë hyjnive,  
që ngritën dhe rritën pellazgët leshtorë.

Edhe në brigje lumenjsh dhe liqerësh  
ujëkulluar si vesa e vjeshtës,  
bregdetesh të kaltër kullotëblerët,  
tek çel bajamja dhe rritet druri  
i ullirit shumë paqedashës,  
në fusha të shtrira — grunarë buke,  
në brinjat diellore, që mbushin qypat,  
calikët dhe bulirat e bungta  
me verë të ëmbël, shumë të fortë,  
në lugje qarkuar me gjerdhe malesh,  
në kreshta krepash të hirtë, në pyje  
të dendur, të moçme sa moti vetë,  
thellë blerishtash kullotëmajme,  
ku rritet dhe shtohet gjëja e gjallë, —  
delet leshbuta me shtat sa të viçit,  
që pjellin për mot binjakë, trnjakë,  
për gzin e hyjnive baritore!  
Në gjithë skajet e vendit të lumur,  
anembanë kumbonte një e folme  
e vetme: ilirishtja e stralltë —  
vigmë barinjsh dhe kushtrim luftëtarësh,  
farkuar në kudhra mijëvjeçarësh,  
me zjarr shkrepëtime dhe gjëmë gjëmimi,

ndër shkulme detesh, zhaurima pyjesh,  
në luftra të rrepta shekullore  
dhe stina qetësie kaltëroshe,  
ku bari lidh mugull dhe pema — gonxhë  
dhe ngjizen fëmijët: hoj dashurie...  
Gjuhë e fortë, vlugmadhe, e ëmbël,  
e mbrujtur para se të ishin mbrujtur  
tufat e hyjnive të lashtësive.

Pa burrat e dheut e donin mbi jetën  
lirinë e shenjtë, të trashëguar  
nga motet e mugët dhe të mbrojtur me kokën;  
njerëz të fismë: të drejtë, mikpritës,  
bujarë në shpirt, bestarë në fjalë,  
që bukën e ndanin me lutësorët,  
kur venin kérkonin strehë dhe ndihmë  
— nga Kadmi i Tebës dhe Harmonia,  
dëbuar nga helenët gërnjëtarë,  
dhe gjer te Themistokliu pendestari,  
gjurmuar nga urrejtja athinjote. —  
Burra të fortë si qarri i kulmit,  
gjithnjë sypatrembur përballë valomash.

Rrëmbyeshëm vërshonin enkelenjtë,  
shpatëtarë, fort të rregjur ndër luftra,  
përmes Heladës, gjer brenda në Delfi,  
matanë Kadmejës, mburojeartës,  
dhe hidhni sheshit vrullshëm valle shpatash  
kundruall faltore të Zot Apollonit,

hyut flokëartë dhe dritëpërndarës,  
në sytë e të mënçurve shortarë  
të shtangur vendit, pasi shihnin përpara  
kaq burräri, bukuri, fismëri.  
Pa detet përshkonin liburnët e shkathët  
të nisur nga vendlindja, nga Korkyra,  
ishulli i blerët në Jonin e kaltër,  
ku ende s'kish shkelur këmbë heleni,  
dhe zbrisnin tej Moresë, tutje Kretës,  
me lundra të shpejta mbi dallgët thinjake.  
Ardianët trima, krenarë, gjakndezur  
s'i ndruheshin shkulmit, njeriut dhe Zotit,  
sepse dhe Zotit të qiellit i hidhnin,  
pa frikë, shigjetën e kuqe të mbathur  
me thumba kokalle largdepërtunjës.  
Në male dhe pyje burrat gjahtarë  
gjahun gjurmonin me heshta të gjata  
dhe zjarre ndiznin për afër burimesh,  
ku piqnin dhe hanin kaprojtë e shijshëm.  
Qetas shtegtonin dalmatët, daorsët  
dhe fise të tjera trime delmëre  
me mandrat, bregdeteve, në vërrri.  
Djathë të lyrshëm parthinët gatonin,  
që shumë e çmonte gjith bota e lashtë;  
verë mjalti ndërtonin taulantët,  
që mikut ia shtronin kur vinte të bujtë.  
Begatshëm rronin të bijtë e Dardanit,  
që dheun lëronin dhe gjethët shumonin

në plëngun e tyre të gjërë shumë.  
Xehtarët pirustë farkonin shpata,  
drapinj për të korrat, kosa për barin.  
Dhe gratë leshin e butë e tirrnin,  
ndaj vinin në krua me shtamba mbi krye.  
Pa anëembanë, në troj të bekuar,  
queshte jeta, lulëzonin qytete:  
Tergesta e bujëshme bregdetare,  
Metuli japod, dhe Vendì, Blandona,  
Salona e bukur, Sirmi murelarti,  
mbi Dravin e gjërë të fisit skordest,  
Narona ardiante, Epidauri,  
Demastioni dardan, Skodra labiate,  
Styberra e gurtë kodrore paione,  
Dyraki, Dymali, Billis, Butroti,  
Amantia e madhe — vatër drite,  
Enkelana e bardhë — qendër trimash,  
Lyhnida e kreptë, varur mbi valë  
dhe shumë qindra qytete me emër,  
që sot nuk janë, por ishin qëmoti...

Pa hanin të gjithë bukën e tyre  
dhe zbrasznin gëzueshëm brirët e verës,  
pa këngën nga jeta kurrë s'e ndanin  
dhe hidhnin bashkë valle trimërie —  
me shpatë në dorë, gjithnjë të gatishëm.

Të hijëshme ishin vashat e reja

dhe nuset — zana, bija bukurie:  
gjahtare mali, baresha, bujkesha,  
zejtare të zellshme, fëmijëshume...  
Dhe moti kur vrenjej — rrëmbenin heshtat  
dhe hidheshin vrundull, krahas me burrat,  
në logune luftës, kundër armikut:  
për mbrojtjen e vatrës dhe gjithë vendit.

Dhe kur këtej u turr ulkonja e Romës,  
e etur, stëretur për gjak dhe për pre —  
shekuj dhe shekuj gjëmuani malet,  
lugjet dhe brigjet nga rropama ndeshjesh  
të rrepta: për mbrojtje e jetë të lirë!  
Pa bashkë me burrat, si shkaba mali,  
luftuan nuset dhe vajzat e njoma,  
që fli burrnisht e bënë të ritë e tyre  
në Iterin e lirisë së embël shumë —  
nga Vendi i Epërmë, nga Panonia,  
te Vendi i Poshtëm, te Paonia,  
dhe brenda Epirit, djep burrash të ndjerë.  
Pa malet dhe fushat ilire u lkuqën  
me çukë gjaku të pastër, të dlirot  
trimash, që emrin dhe kockat bashkuan  
për jetë e mot me dheun bukëdhënës:  
gjak dalmat, dardan, ardian, breuk,  
dhe gjak farkëtarësh pirustë, desidiatë,  
gjak delmerësh parthinë dhe kandavë,  
gjak dokleat, autariat dhe alban

dhe shumë gjak kaon, mollos, thesprot  
dhe fisesh të tjera të dheut t'Ilirisë:  
një fare dhe gjuhe, por — vaj! — të ndarë,  
pa besëlidhje armësh... pëllëmbë e hapur,  
që grusht nuk u bë për të goditur rëndë  
armikun që turrej të zgrapë plëngun...



Dhe gjakataret legjone romake  
— skota të larme të shkulura vattrash  
dhe shtyrë nga krerët me shufrën e dhunës —  
goditën veçse njërin pas tjetrit  
shtetet e vegjël dhe fiset ilire,  
që jetë bënin më vete, pavarur;  
vendin shkretuan me hekur dhe zjarr  
në luftra t'ashpra, që zgjatën shekuj,  
dhe s'lanë gur mbi gur prapa tyre,  
por veç gërmadha dhe varre panumër —  
të vetat dhe të mbrojtësve të vendit.

Por rishtas dhe rishtas mbi grumbuj kokallash,  
mbi hi dhe gërmadha tek rritej shpendra,  
më këmbë brofën brezat e reja,  
që zgjedhën s'e donin, por vetëm lirinë.  
Pa mote rrebeschesh dhe ngritjesh krye  
shënuan pareshtur hapin e kohës  
në gjithë botën e gjerë ilire,  
me krisma t'hovëshme shpate, sëpate,  
në dritë dielli, në terre netesh,

në prita të forta ngrehur në rrugë,  
poshtë — lugajash, dhe sipër — qafmalesh,  
në vahe lumenjsh, në brigje liqerësh,  
që tundën thellë themelet e dhunës  
dhe gjakatarëve datën u kallën,  
ndër lëmë i gjeshën — rrrethuar me ledhe  
dhe ndër fortesa me zoje nën armë,  
pa lart, në malet, vazhdoi të rrahë  
filladi i kuq i lirisë sëëmbël,  
që dot nuk e ndalnin legjonet e Romës.

Më tej, kur pcofi ulkonja romane,  
u derdhën shvalina bijsh shkretëtirash,  
të dalë nga fundra gufash dhe honesh,  
me urë në dorë, me thikë ndër dhëmbë...  
Rruagaja heshtash muzgëtuan qiejt,  
orteqe zjarri vrundull përflakën  
dheun e bukur të bijve t'Ilirit:  
rrëname, rrëmbime, varrime së gjalli  
fëmijësh të mitur... Suvala gjaku  
shënuan tragat e dyndjes barbare —  
së parë, së dytë, së pestë, së shtatë.  
Dhe prapë e prapë, në luftra të reja  
brofën trimat dhe hodhën hordhitë  
njérën pas tjetrës tej Dravit, tej Savit  
dhe brenda në amën e lumit të gjerë,  
strëmadhit Danouv valëvezullonjës...  
Por lukunitë nuk kishin të sosur,

se pas një skote — një tjetër vërvshonte  
nga fundra gufash dhe stërfundra honesh,  
me urë në dorë e thikë ndër dhëmbë,  
që kishin banesa tenda lëkurësh.

... Dhe shumë, më shumë u ndrydhën caqet  
e zotërve të qëmoçëm të dheut  
nga llavat e dyndura së jashtmi,  
por malet ilire shekuj qëndruan  
të pastër, pa gjurmë këmbe armiku,  
sepse atje me ngulm vazhdonte lufta.

Hej, histori! Ti, histori e lashtë  
e botës ilire  
përse më bren e bluan kaq dhimbshëm  
në orët e vogla të natës së bardhë?

. . . . . : :

Rrjedhin lumenjtë e gjerë ujëshumë  
në caqet e botës së moçme ilire,  
por s'janë më ilirë, ndonse mbajnë  
emrat e moçme, përpara vërvshimesh.  
Lartohen hovshëm malet krenare,  
shtrihen rrafshinat dhe fushat e gjera —  
përmbytur nga popuj të huaj, të dyndur  
nga skajet e dheut të largët shumë,  
që shkelin muranat tek zbardhiq ende  
togje kokallash dhe eshtrash ilire,  
zotërve të parë të gjithë vendit.

Por, hej! Mes rrebeshesh dhe shembëtyrash,  
që fshinë e zhdukën faqes së tokës  
shtete dhe fise të shumta ilire,  
qëndroi i pamposhtur biri m'i vogël  
i Ilirit të lashtë, trim Arbër,  
që mblođhi rrëth tij dhe ngriti në luftë  
thërmia dhe grimca fisesh vëllezër  
në këndin malor t'Ilirisë së Poshtme,  
buzë Jonit të kaltër dhe të Adrias  
Valëdendur: malësorë dardanë,  
labeatë dhe pirustë vishkullarë,  
bregdetas kaonë gunëdhirtë,  
atintanë, eordenj, dasharetë. . —  
dhe bashkë u bënë një grusht i shtrënguar  
ballë u bënë armiqve, stuhive,  
dyndësve varre u dhanë, për shpagë,  
mbajtën plëngun, fisin, gjuhën e moçme —  
arbërishten — pinjolle t'ilirishtes,  
lart e lart ngriten trashëgimin arbër  
n'Ilirinë e Vogël. . .

Mbani, burra,  
me dorë të fortë flamurin e Arbërit  
të skuqur me gjak ndër luftra të rrepta.



## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Në vend të parathënjes .....	3
Balada e pyllit të gështenjave .....	7
Balada e udhës nëpër natë .....	25
Letra e fundit e një djaloshi partizan .....	37
Kartë nga Shëndaumi .....	53
Teuta Ilire .....	64
Spartaku .....	67
Varr milici .....	68
Prishtina .....	70
Natë vjeshte .....	71
Baltës shqiptare .....	73
Gjuhës shqipe .....	76
Laloti .....	79
Esat Pasha .....	81
Efremi i Gjinit .....	82
Dje dhe sot në fishatin tim .....	83
Këngë .....	89
Shtambari .....	91
Argjiri i Colit .....	94
Balada e zogut të vogël të dallëndyshes .....	99
Pranvera në Enkelanën e Re .....	103

	Faqe
Një ndajnatë në Poradecin e vjetër .....	107
Pranvera e plakut .....	113
Pranvera e qershisë së vogël .....	115
Plepi dhe qershia .....	116
Po të vdes në dhe të huaj .....	119
T'i mora duart .....	120
Bie shi .....	121
Më di, a nuk më di .....	123
Ëndërrimet e një nate prilli .....	124
Nisje për mërgim .....	127
Tani që shkuan .....	128
Panja .....	129
Prilli .....	130
Dil në prak .....	131
Hëna e humbur .....	132
Pranvera e bajames së vogël .....	133
Pranvera e plepit plak .....	136
Kroi i Kodrës .....	139
Pranvera, në Myzeqenë e re. ,.....	142
Rrjedhin lumenjtë .....	144